



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister

Zyra për Qeverisje të Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/Office on Good Governance

HARTËZIMI DHE VLERËSIMI I SISTEMIT TË MBROJTJES SË FËMIJËVE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Përmbajtja

Fjala hyrëse	7
1.Hyrje.....	9
2.Rekomandimet kryesore.....	11
3.Metodologjia	13
4.Sistemi i mirëqenies sociale, shëndetit dhe arsimit	19
4.1 Gjetjet kryesore	20
4.2 Rekomandime	27
4.2.1 Rekomandimet për të forcuar kornizën ligjore dhe politike në mbrojtjen e fëmijëve:	27
4.2.2 Rekomandimet lidhur me përmirësimin e zbatimit të ligjeve dhe politikave:	28
4.2.3 Rekomandime lidhur me përmirsimin e koordinimit ndërmjet institucioneve dhe funksionimin e sistemit:.....	29
4.2.4 Rekomandimet për të adresuar kapacitetet e resurseve njerëzore, analizës së situatës dhe normave shoqërore lidhur me mbrojtjen e fëmijëve:	31
5. Sistemi i drejtësisë për fëmijët dhe qështjeve të sigurisë.....	33
5.1 Gjetjet kryesore	34
5.2 Rekomandime	40
5.2.1 Amandamentimi dhe plotësimi i strategjive ekzistuese dhe legjislacionit, përfshirë hartimin e ligjeve të reja dhe akteve nënligjore përkatëse:	40
5.2.2 Çështje në lidhje me zbatimin e ligjit	40
5.2.3 Çështje në lidhje me koordinimin midis institucioneve dhe funksionimin e sistemit	41
5.2.4 Çështje në lidhje me ngritjen e kapaciteteve (trajtimeve), analizim të situatës dhe aktivitete vetëdijesuese.....	42
6.Sistemi dhe shoqëria civile	45
6.1. Gjetjet kryesore	45
6.2 Rekomandime	48
6.2.1 Amandamentimi dhe plotësimi i strategjive ekzistuese dhe legjislacionit, duke përfshirë hartimin e ligjeve të reja dhe akteve nën-ligjore përkatëse:.....	48
6.2.2 Rekomandime në lidhje me zbatimin e ligjit:.....	48
6.2.3 Rekomandime në lidhje me koordinimin ndërmjet institucioneve dhe funksionimin e sistemit:.....	48

7. Burimet financiare dhe kostoja e sektorëve dhe Programeve	49
7.1 Gjetjet kryesore për procesin e financimeve publike	49
7.2 Gjetjet kryesore për financimin nga donatorët.....	51
7.3 Gjetjet në alokimin e buxhetit në nivelin sektorial dhe të programit.....	52
7.4 Rekomandime	55
7.4.1 Amandamenti dhe plotësimi i strategjive ekzistuese dhe legjislacionit, duke përfshirë hartimin e ligjeve të reja dhe akteve nën-ligjore përkatëse:.....	55
7.4.2 Rekomandime në lidhje me koordinimin ndërmjet strukturave dhe funksionimin e sistemit	55
7.4.3 Çështje në lidhje me ngritjen e kapaciteteve (trajnime), aktivitete të analizimit të situatës dhe vetëdijesimit:	55
 Aneksi 1 - Skema e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në nivel qendror	57
Aneksi 2 - Skema e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në nivel lokal	58
Aneksi 3 - Skema e sistemit të drejtësisë dhe sigurisë.....	59
 Bibliografia:	60

Lista e Akronimeve:

DSHMS	Departamenti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
DQD	Departamenti për Qasje në Drejtësi
DÇL	Departamenti për Çështje Ligjore
DIEKP	Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave
DBJN	Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar
DML	Departamenti i Mjekësisë Ligjore
ECLO	Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian
ESK	Enti i Statistikave të Kosovës
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
IPA	Instrumenti i para-anëtarësimit
IPS	Instituti i Politikave Sociale
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KNJK	Komisioni për Ndihmë Juridike të Kosovës
KNM	Këshilli Ndër-ministrot
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KRDM	Këshilli i Reformës për Drejtësinë për të Mitur
KPEFTPF	Këshilli mbi Parandalimin dhe Eliminimin e Formave të Rënda të Punës së Fëmijëve
GVK	Grupet e Veprimit të Komunave
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MIE	Ministria e Integritimit Evropian
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MASHT	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
NJDNJ	Njësia për të Drejtat e Njeriut
OJQ	Organizatë Joqeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë
QPS	Qendra për Punë Sociale
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
PVAL	Programi i Vazhdueshëm për Arsimimin Ligjor
PK	Policia e Kosovës
PTA	Programi Trajnues për Avancim
PFAL	Programi Fillestar për Arsimimin Ligjor
RAE	Komuniteti Romë, Ashkali dhe Egjiptian
ShKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
ShSK	Shërbimi Sprovues i Kosovës
TDH	Terre des Hommes
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
ZQM-ZKM	Zyra për Qeverisje të Mirë-Zyra e Kryeministrit

Fjala hyrëse

Hartëzimi dhe vlerësimi i Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve në Kosovë është realizuar përmes një qasje gjithëpërfshirëse, me ndihmën dhe përkrahjen e përbashkët të institucioneve vendore relevante të cilat kanë mandat për mbrojtjen e fëmijëve. Ky proces është përkrahur nga projekti i përbashkët i financuar nga Bashkimi Europian dhe UNICEF'i, "mbështetje e reformave të sistemit të drejtësisë për të mitur në Kosovë - faza 2, 2010-2013". Ky ishte një proces shumë kompleks dhe inovativ për faktin se një vlerësim i tillë po bëhej për herë të parë në Kosovë si dhe për faktin se kemi të bëjmë me një sistem i cili në vete ngërthen shumë institucione dhe sektorë relevant të cilët kanë rol dhe mandat në mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve.

Për realizimin e këtij vlerësimi është aplikuar një metodë e re e hartëzimit dhe vlerësimit, duke zbatuar metodologjinë e Bashkësisë së Instrumenteve e cila në vete përmban 100 pyetje që janë në linjë me standardet ndërkombëtare dhe Europiane lidhur me mbrojtjen dhe drejtësinë për fëmijë. Bashkësia e instrumenteve globale është përpiluar nga zyra qendrore globale e UNICEF-it e dizajnuar për përdorim në kontekstin global, por duke u adaptuar në kontekst lokal. Metodologjia e Bashkësisë së Instrumenteve e adoptuar dhe e kompletuar për Kosovën është e bashkangjitur tek raporti në CD. Duhet të theksohet se Metodologjia e Bashkësisë së Instrumenteve është një dokument punues i cili mund të rifreskohet dhe të rishikohet siç situata e kërkon.

Kompania konsulente DeLegibus ka lehtësuar fazën e parë të vlerësimit që ishte nën udhëheqjen e Këshillit Drejtues në Drejtësi për të Mitur.

Finalizimi i hartëzimit dhe vlerësimit, si dhe validimi i të gjeturave dhe rekomandimeve të dalura nga procesi, është bërë nën udhëheqjen e Këshillit për Mbrojtje dhe Drejtësi të Fëmijëve. Ky këshill i themeluar nga Zyra e Kryeministrit të Kosovës dhe nën udhëheqjen e Zyrës për Qeverisje të Mirë, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, njëherit është themeluar edhe si rrjedhojë e rekomandimeve të dala nga procesi i vlerësimit. Duke pasur parasysh kompleksitetin e këtij procesi mund të konstatohet se të gjeturat më tepër prezantojnë hartëzimin e sistemit se sa ndonjë analizë më të thellë të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve.

Korniza kohore e shtrirjes së vlerësimit dhe hartëzimit përfshin periudhën nga viti 2010 e deri në gjysmën e parë të vitit 2012.

Të gjeturat dhe rekomandimet në përgjithësi reflektohen nga konteksti kohor i sistemit për periudhën e fundit dy vjeçare, megjithatë mund të konkludohet se ato mund të përdoren gjerësisht nga Qeveria e Republikës së Kosovës në procesin e përpilimit të politikave dhe programeve si pjesë e reformave të vazhdueshme që janë duke u zhvilluar në kuadër të Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve në Republikën e Kosovës.

Në fund dëshiroj të falënderoj të gjithë aktorët relevant të cilët u angazhuan dhe kontribuan në realizimin dhe finalizimin e këtij vlerësimi duke përfshirë: Këshillin për Mbrojtje dhe Drejtësi për Fëmijë, të gjitha ministritë e linjave relevante, kompaninë konsulente DeLegibus, agjensionet zhvillimore dhe donatorët, institucionet e pavarura, organizatat jo-qeveritare, dhe fokus grupin e fëmijëve të cilët kontribuan në këtë proces.

Një falënderim i veçantë duhet t'i drejtohet Zyrës së Bashkimit European në Kosovë dhe zyrës së UNICEF'it në Kosovë, për kontributin e tyre financiar por edhe teknik në funksion të realizimit të suksesshëm të këtij vlerësimi.

Raporti i këtij vlerësimi publikohet nën autoritetin e Këshillit për Mbrojtje dhe Drejtësi për Fëmijë.

Me respekt

Z.Habit Hajredini

Kryesues i Këshillit për Mbrojtje dhe Drejtësi për Fëmijë i Republikës së Kosovës

1. Hyrje

Bordi Ekzekutiv i UNICEF-it e miratoi Strategjinë e re për mbrojtjen e fëmijëve¹ në qershor të vitit 2008. Strategjia e promovon një qasje të mbrojtjes së fëmijëve që çon drejt krijimit të një mjedisi mbrojtës dhe forcimit të sistemeve për mbrojtjen e fëmijëve. Ajo i përshkruan sistemet për mbrojtjen e fëmijëve si një pako ligjesh, politikash, rregulloresh, shërbimesh, kapacitetesh, monitorimit dhe mbikëqyrjes së nevojave në të gjithë sektorët socialë - e veçanërisht në mirëqenien sociale, në arsim, në shëndetësi, në siguri dhe në drejtësi - me qëllim të përmirësimit të mekanizmave parandalues dhe të reagimit mbështetës kundrejt faktorëve kryesorë të rrezikut. Këto sisteme janë pjesë e mbrojtjes sociale, megjithatë i tejkalojnë kufijtë e saj. Në shkallën e parandalimit, synimi i tyre ka të bëjë me mbështetjen dhe forcimin e familjeve në reduktimin e përjashtimit social dhe në zvogëlimin e rrezikut nga ndarja, dhuna dhe shfrytëzimi.

Duke qenë se deri më tani nuk ka pasur ndonjë vlerësim gjithëpërfshirës të sistemit për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë, dhe për shkak se strategjia globale e UNICEF-it për mbrojtjen e fëmijëve bën thirrje për “zhvillimin dhe zbatimin e instrumenteve analitike për hartëzimin dhe vlerësimin e politikave ekzistuese për mbrojtjen e fëmijëve, pastaj të ligjeve dhe shërbimeve nëse ato janë të përshtatshme, si dhe identifikimin e pengesave dhe mundësive në zbatimin, e veçanërisht në trajtimin e grupeve të cenuara ose të përjashtuara”, atëherë, në vitin 2010, UNICEF-i e mori iniciativën për zhvillimin e një procesi të hartëzimit dhe të vlerësimit të sistemit për mbrojtjen e fëmijëve në konsultim dhe bashkëpunim të ngushtë me qeverinë.

Qëllimi i hartëzimit dhe i vlerësimit të sistemit për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë është që ta mbështes zhvillimin e një sistemi apo sistemeve në nivel të shtetit, i cili është gjithëpërfshirës karshi mbrojtjes së fëmijëve, si përgjigje ndaj një sistemi për mbrojtjen e fëmijëve, i cili bazohet në paraqitjen e problemeve, dhe i cili jo rrallë del të jetë një reagim i fragmentuar ndaj mbrojtjes së fëmijëve, e që shquhet për një mos efikasitet dhe mospërmbushje të shumë nevojave me rastin e mostrajtitimit të çështjeve apo problemeve të tjera. Në veçanti, vlerësimi synonte:

- T’u ofrojë palëve kryesore të interesit një pamje të qartë të strukturës dhe funksioneve të sistemit aktual për mbrojtjen e fëmijëve;
- Ta përshkruajë kornizën aktuale ligjore dhe normative, duke i spikatur anët e forta, si dhe ta përshkruajë agjendën e ardhshme të politikave të vendit në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve;
- T’i vë në pah rreziqet kryesore me të cilat ballafaqohen fëmijët, dhe prioritizimi i kërkesave për të dhëna që shërbejnë për monitorimin dhe vlerësimin e mbrojtjes së fëmijëve në një vend;
- Duke u mbështetur në praktikat më të mira globale, të vlerësojë kapacitetet e strukturave zyrtare dhe jozyrtare (ministrive, agjencive, partnerëve, bashkësive, etj) për zhvillimin, administrimin dhe zbatimin me efikasitet, pastaj monitorimin dhe vlerësimin e përgjegjësive që i kanë karshi mbrojtjes së fëmijëve;

1 UNICEF Child Protection Strategy, Executive Board Annual Session, 2008. E/ICEF/2008/5/Rev.1.

- Të identifikojë dhe prioritzojë mundësitë për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve;
- T'i sjellë së bashku aktorët kryesorë për identifikimin e prioriteteve për mbështetjen e zhvillimit të sistemit për mbrojtjen e fëmijëve; dhe
- Të krijojë një kornizë për burimet financiare dhe njerëzore që nevojiten për zbatimin e prioriteteve.

Rezultatet e vlerësimit kanë të bëjnë me të kuptuarit e mirëfilltë të sistemit për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë nga një pikëpamje gjithëpërfshirëse dhe shumë-sektoriale, si dhe bazohet në një proces dhe qasje me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse. Vlerësimi ka ndihmuar në prioritzimin e një varg veprimesh të rëndësishme për zbatim afatshkurtër, të cilat do të merren parasysh nga Këshilli i ri për Mbrojtjen dhe Drejtësi për Fëmijët, e që do të përfshihen në strategjitë ekzistuese që ka të bëjë me mbrojtjen e fëmijëve. Në të ardhmen, të gjeturat dhe rekomandimet (shih aneksin 1), mund të merren parasysh me rastin e përditësimit apo rifreskimit të Strategjisë kombëtare dhe planit të veprimit për të drejtat e fëmijëve 2009-2013, e në veçanti të komponentëve që kanë të bëjnë me drejtësinë për të mitur dhe mirëqenien sociale.

2. Rekomandimet kryesore

Rekomandimi 1:

Amandamenti dhe plotësimi i strategjive ekzistuese dhe legjislacionit për mbrojtjen e fëmijëve, përfshirë hartimin e ligjeve të reja dhe akteve nënligjore përkatëse.

Rekomandimi 2:

Draftimi i formave unike të referimit të dhunës dhe abuzimit, e cila do të shfrytëzohej në të gjitha institucionet dhe OJQ-të, që për shkak të mandatit apo rolit të tyre vijnë në dijeni të rasteve të fëmijëve të abuzuar apo neglizhuar. Më konkretisht, format unike apo standarde të referimit duhet të hartohen për mësuesit apo personelin ndihmës në shkolla, për mjekët dhe infermieret, për nëpunësit e shërbimit social, zyrtarët e policisë, mbrojtësit e viktimave, prokurorët, gjyqtarët dhe avokatët që merren me identifikimin, referimin trajtimin e rasteve të dhunës.

Rekomandimi 3:

Hartimi i protokolleve standarde të trajtimit dhe të menaxhimit të rasteve për secilin profesionist të ndërlidhur në mbrojtjen e fëmijëve. Procesi i hartimit të tyre duhet bërë në mënyrë të koordinuar dhe të kuptueshme dhe këto protokole duhet miratuar nga institucionet përkatëse.

Rekomandimi 4:

Zyra e Qeverisjes së Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit në bashkëpunim me Ministrinë e Integritimit European duhet të themelojë një grup punues ndër-institucional për koordinimin e donatorëve në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.

Rekomandimi 5:

Ndërtimi i kapaciteteve, rritja dhe përmirësimi i cilësisë së trajnimeve për krijimin e mundësisë për respektimin e të drejtave të fëmijëve në institucionet relevante, në linjë me standardet ligjore të Kosovës dhe ato ndërkombëtare.

Rekomandimi 6:

Bazuar në Ligjin për Gjykata (Ligji Nr. 03/L-199), do të krijohen Departamentet për të mitur pranë çdo gjykate themelore dhe një pranë Gjykatës së Apelit, si dhe i seksioneve relevante brenda zyrave të Prokurorive. Në këtë kuadër është e nevojshme përmirësimi i infrastrukturës së punës për gjyqtarët dhe prokurorët në përgjithësi për të qenë në përputhje me standardet e të drejtave të fëmijëve.

Rekomandimi 7:

Monitorimi i ndryshimeve eventuale të të Ligjit për Financat Lokale (Ligji nr. 03/L-049) dhe ligjeve të tjera, për të siguruar që të bëhen ndryshimet e nevojshme për fondet e burimeve të financimit për mbrojtjen e fëmijëve në të gjithë sektorët.

Rekomandimi 8:

Forcimi i rolit të mekanizmave të monitorojnë për të mitur në konflikt me ligjin, për të monitoruar kushtet e trajtimit të tyre. Këta mekanizma duhet të luajnë një rol të rëndësishëm në monitorimin e institucioneve që merren me fëmijët në konflikt me ligjin. Në këtë kuadër rekomandohet të fuqizohet roli i Njësive për të Drejtat të Njeriut në nivel qendror dhe lokal, dhe në Zyrën për Qeverisje të Mirë.

Rekomandimi 9:

Rekomandohet një koordinim qendror i donatorëve në nivel ministror dhe në nivel qeveritar. Rritja e fondeve buxhetore në ofrimin e shërbimeve për fëmijët brenda sistemit të drejtësisë, posaqërisht të krijohet fondi për dëmshpërblimin e viktimave, kompensimit dhe fondi emergjent për viktimat e krimit.

Rekomandimi 10:

Amandamenti i legjislacionit për krijimin e infrastrukturës për kompensimin financiar të nënkontraktuesve të shërbimeve sociale dhe dhënien e granteve OJQ-ve që kontribuojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.

Rekomandimi 11:

Rritja dhe përmirësimi i hapësirave adekuate për fëmijët e ndaluar në stacionet policore, bazuar në eksperiencën e pilot projektit “Dhoma Miqësore të Intervistimit të Fëmijëve,” dhe nevoja për shtrirjen në të gjithë vendin.

Rekomandimi 12:

Miratimi i kriterëve të licencimit të OJQ-ve të përfshira në mbrojtjen e fëmijëve dhe iniciimi i procesit të licencimit.

Rekomandimi 13:

Krijimi i infrastrukturës ligjore, për të garantuar dhe koordinuar të gjitha aktivitetet e OJQ-ve të ndryshme në fushën e mbrojtjes së fëmijëve në nivel lokal. Kjo infrastrukturë duhet të përfshijë përshkrimin e punës të Zyrtarit për të Drejtat e Njeriut si Koordinator për Mbrojtjen e Fëmijëve në nivel lokal, bazuar në praktikën e Task Forcës së terre des hommes dhe të modelit të ndërhyrjes së Save the Children.

3. Metodologjia

Pakoja e instrumenteve të UNICEF-it për hartëzim dhe vlerësim të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve

Në fillim të vitit 2011, UNICEF-i në partneritet me qeverinë e ka kontraktuar firmën konsulente juridike DeLegibus për të ndihmuar në zbatimin e vlerësimit të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Kosovë, duke përfshirë edhe hartëzimin e institucioneve të ndryshme dhe të palëve të interesit që merren me mbrojtjen e fëmijëve.

Kosova ishte vendi i parë në rajon që po e shfrytëzonte pakon e re të instrumenteve të zhvilluara dhe të pilotuara nga UNICEF-i dhe partnerët e tjerë të rëndësishme në nivelin global, si UNHCR-ja dhe Save the Children (shiko bashkësinë e instrumenteve të bashkëngjitura në CD). Përdorimi i kësaj pakoje instrumentesh ka për synim ofrimin e një metode praktike dhe miqësore të përdorimit, e cila u mundëson ekipeve vendore për mbrojtje të fëmijëve, për t'i identifikuar rreziqet kryesore në mbrojtjen e fëmijëve në kuadër të kornizës së të drejtave të tyre, si dhe për ta ekzaminuar fushëveprimin dhe kapacitetet e sistemit aktual të mbrojtjes së fëmijëve (edhe formale edhe joformale), pastaj të mekanizmave përgjegjës, dhe të qasjeve për mobilizimin e resurseve.

Gjatë futjes së të dhënave në këtë pako të instrumenteve iu kushtua kujdes i veçantë fushave të specializuara të interesit dhe/ose institucioneve plotësuese për përfundimin e këtyre qëllimeve në vijim si: verifikimin e kornizës ligjore, kontributin nga burimet dytësore të informacionit siç janë të dhënat nga studimet dhe dokumentet relevante të shkruara, si dhe të dhënat statistikore nga pikëpamja e institucioneve përkatëse shtetërore të Kosovës ose nga partnerë ndërkombëtarë (p.sh. Banka Botërore, UNICEF-i dhe UNDP-ja); dhe të rezultateve të intervistave me fëmijët e Kosovës. DeLegibus, së bashku me institucionet lokale të përfshira në proces, kontribuoi në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave.

Procesi i mbledhjes dhe i analizimit të dhënave për ta plotësuar pakon e instrumenteve përfshinte identifikimin e zbatimit të kornizës ligjore me qëllim të vënies në pah të ndonjë zbrastësie në praktikën aktuale ose zbatimin e standardeve të tilla. Ekipi konsulentë i ekzaminoi, po ashtu komponentët e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve nga pikëpamja e funksionimit të institucioneve shtetërore në aspektin praktik dhe juridik. Kjo analizë mori parasysh bashkëpunimin si në nivelin qendror, ashtu edhe atë lokal, e gjithashtu edhe bashkëpunimin ndërinstucional. Dhe së fundit, procesi përbëhej edhe prej mbledhjes së të dhënave financiare sa i përket financave publike (buxhetit) me qëllim të mundësimin të analizës së kostos për programet dhe sektorët e mbrojtjes së fëmijëve.

Procesi i vlerësimit

Mbledhja dhe analiza e informacioneve të përmendura më lart u bë nga konsulentët në bashkëpunim të ngushtë me UNICEF-in. I gjithë hulumtimi u bë gjithashtu edhe në partneritet të plotë me Këshillin Ndërqeveritar². Ky këshill, të cilit i referohemi, u zgjerua përkohësisht edhe me anëtar të tjerë duke përfshirë përfaqësues nga agjencione përkatëse qeveritare dhe ato të pavarura me të vetmin qëllim të hartëzimit dhe të vlerësimit të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve.

² Ky Këshill është themeluar në bazë të rregullorës "Rregullave të procedurave të Këshillit drejtues për reformimin e sistemit të drejtësisë për të mitur", dokument i miratuar nga Ministria e Drejtësisë, Prill 2010.

Këshilli ndërqeveritar, ka shërbyer si strukturë bërthamë për ta mbështetur dhe ndihmuar zbatimin e vlerësimit. Këshilli ndërqeveritar funksiononte në pajtim me detyrat e punës të miratuara nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë dhe ai i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Antarët e Këshillit u ndanë në katër nën-këshille, dhe si të tillë, vepronin si grupe tematike të punës që korrespondojnë me komponentët themelorë dhe me instrumentet e ndryshme të pakos së instrumenteve, si në vijim:

- Çështjet e mirëqenies sociale, duke përfshirë shëndetin dhe arsimin;
- Çështjet e drejtësisë dhe të sigurisë;
- Zhvillimi i sistemit/shoqëria civile; dhe
- Mobilizimi i resurseve, duke përfshirë koston e programit dhe të sektorit.

U mbajtën disa punëtori gjatë së cilave secili prej grupeve shqyrtonte dhe diskutonte pyetje të ndryshme që dilnin në seksionin përkatës të pakos së instrumenteve, duke i përmbledhur kështu informatat si dhe duke i analizuar të dhënat dhe informatat të cilat do të përfshiheshin në këtë raport. Pas plotësimit të pakos së instrumenteve, firma konsulente e hartoi raportin përfundimtar me të gjeturat dhe rekomandimet kryesore. Informacioni në pakon e instrumenteve dhe në vetë raportin janë diskutuar dhe verifikuar nga të gjithë pjesëmarrësit në vlerësim, duke përfshirë institucionet vendore dhe ndërkombëtare si dhe OJQ-të.

Perspektiva e fëmijëve

Pjesëmarrjes së fëmijëve iu dha prioritet shumë i lartë gjatë tërë procesit, si parim bazë i të drejtave të fëmijëve në të gjithë procesin e vendimmarrjes, e veçanërisht sa i përket vendimeve që kanë mundësinë të ndikojnë në mënyrë dramatike në jetën e fëmijëve. Mundësitë për t'i konsideruar mendimet e fëmijëve qenë garantuar përmes intervistave individuale gjysmë të strukturuar, të protokolleve të veçanta të zhvilluara për fëmijët në secilën prej katër kategorive më poshtë:

- Fëmijët në kujdesin rezidencial dhe/ose në strehim familjar. U realizuan shtatë intervista me fëmijët e moshës 14-17 (pesë në institucionet rezidenciale; dy në strehim familjar).
- Fëmijët në punë. U realizuan tri intervista me fëmijët që punonin dhe/ose kërkonin lëmshë.
- Fëmijët në konflikt me ligjin. U realizuan tri intervista me fëmijët të cilët ose janë në institucionin e mbajtjes (Qendra Edukuese Korrektuese e Lipjanit) ose duke e vuajtur ndonjë dënim tjetër (fëmijë nga: Prishtina, Peja dhe Gjilani).
- Fëmijë viktimë ose dëshmitar të abuzimit fizik ose seksual. U realizuan dy intervista (njëri viktimë e abuzimit fizik; tjetri viktimë e abuzimit seksual).

Përfshirja dhe konsiderimi i komuniteteve pakicë

Duke pasur parasysh përbërjen me popullsi të ndryshme të Kosovës, iu kushtua kujdes i veçantë përfshirjes së mendimit dhe të konsiderimit të komunitetit serb në Kosovë. Për këtë qëllim u mbajtën takime me përfaqësues të institucioneve dhe shoqërisë civile nga Graçanica, një komunë me shumicë sërbe. Këto takime kishin qëllim të dyfishtë: (i) për ta plotësuar pakon e instrumenteve me informacionin e nevojshëm; dhe (ii) për ta verifikuar informacio-

nin e mbledhur dhe për t'u siguruar se pakoja përfundimtare e instrumenteve e reflektonte mendimin e komuniteteve të ndryshme e po ashtu edhe të institucioneve të Kosovës. Ky vlerësim e kishte për synim tërë sistemin (funksionimin, strukturat dhe kapacitetet), duke pasur parasysh se institucionet shtetërore nuk bëjnë dallim mes grupeve etnike sa i përket qasjes së sistemit të mbrojtjes së fëmijëve dhe/ose ofrimin e shërbimeve përkatëse.

Verifikimi i informacionit

Metodologjia siguron që antarët e Këshillit Ndërqeveritar të mund ta verifikonin informacionin e mbledhur gjatë punës. Për më tepër, partnerët ndërkombëtarë nga organizatat si, UNDP, IOM, EULEX, dhe UNHCR kishin një rol të rëndësishëm në verifikimin e të dhënave. Në këto suaza, ekipi i DeLegibus, që shërbente si sekretariat, organizoi takime individuale dhe takime me grupe të vogla të punës me profesionistë ose zyrtarë të tjerë, të cilët nuk ishin pjesë e Këshillit Ndërqeveritar ose e nën-këshilleve të ndryshme. Kjo shërbente për të siguruar bashkëpunim të vazhdueshëm dhe shkëmbim të informacioneve mes niveleve të ndryshme të palëve të interesit dhe përfaqësuesve të institucioneve shtetërore, duke përfshirë edhe komente dhe kontribute të mundshme nga aktorët përkatës të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Kosovë. Takimet ndihmuan në mbledhjen e informacioneve të përgjithshme, si dhe krijuan një atmosferë ku bëhej përzgjedhja transparente e informacionit relevant në bazë të së cilës mund të bëhej vlerësimi.

Përveç kësaj, u organizuan edhe takime dhe grupe të vogla punuese me partnerë dhe organizata donatore; kjo ofroi një platformë për debate të mëtejme për rezultatet e vlerësimit dhe ndihmoi në zhvillimin e një të kuptuari të përbashkët të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Kosovë. Po ashtu, ato ofruan një forum për mbledhjen e komenteve, sugjerimeve, mendimeve, dhe, në disa raste, verifikimin e informacionit, të gjeturave dhe rezultateve të hulumtimit në çështje të veçanta që dolën nga nën-këshillet, e veçanërisht nga nën-këshilli për mobilizimin e resurseve, të cilat janë pasqyruar në vlerësim.

Metodologjia për hartëzimin dhe vlerësimin e financave publike dhe të donatorëve në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve, duke përfshirë koston e programit dhe të sektorit

Instrumentet për mobilizimin e resurseve të përgjegjesisë fiskale në seksionin 4 të pakos së instrumenteve, si pjesë të pakos së përgjithshme për vlerësimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, synonte në vlerësimin e nevojave njerëzore dhe financiare dhe në vlerësimin e shkallës së përfshirjes së mbrojtjes së fëmijëve si një vijë buxhetore gjatë procesit të buxhetimit. Instrumentet e ndryshme në këtë seksion u fokusuan në procesin e buxhetimit vjetor dhe në rolin dhe aktivitetet e donatorëve.

Procesi i buxhetimit të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Republikën e Kosovës u bë në pajtim me pakon e instrumenteve të zhvilluar nga UNICEF-i dhe konsistonte në buxhetimin në bazë të programeve dhe të sektorit në nivelet qendrore dhe lokale. Vlerësimi kishte për synim eksplorimin e sistemit aktual të buxhetit, duke e marrë për bazë vitin 2010 dhe duke ofruar parashikim për periudhën 5 vjeçare deri në vitin 2015 në bazë të sektorëve dhe programeve të konsoliduara gjatë fazës së hartëzimit. Duke pasur parasysh natyrën ndërsektoriale, të dhënat për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha ministritë dhe institucionet e pavarura që janë kyçur në ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve, u morën parasysh gjatë procesit.

Modeli i buxhetit, i ofruar fillimisht në pakon e instrumenteve të zhvilluar nga UNICEF'i, u modifikua paksa për t'i pasqyruar rrethanat lokale, si përfshirja e njësive të një vije buxhetore për kategoritë e ndryshme të shpenzimeve që janë relevante në rastin e Kosovës në lidhje me strukturën buxhetore.

Dy sektorët kryesorë që u buxhetuan ishin si në vijim:

- Sektori i mbrojtjes sociale, në të cilin përfshiheshin programet nga MPMS, MSH, MASHT'i, dhe
- Sektori i drejtësisë dhe sigurisë, në të cilin përfshiheshin programet nga MD, Departamentet relevante të Policisë së Kosovës, Këshilli Gjyqësor, ndihma juridike, zyra e avokatit të popullit.

Meqë Qeveria e Republikës së Kosovës nuk kishte vijë të veçantë buxhetore për mbrojtjen e fëmijëve, grupet e ekspertëve e zhvilluan një metodë të veçantë për identifikimin e kostos në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga buxheti i shtetit. Metodologjia bazohet në konceptet e mbrojtës së fëmijëve sipas përkufizimeve të UNICEF-it. Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve përbëhet prej një varg ligjesh, politikash, rregulloreve dhe shërbimeve që nevojiten në të gjithë sektorët social – posaçërisht në mirëqenien sociale, arsim, shëndetësi, siguri dhe drejtësi, për të mbështetur parandalimin dhe reagimin ndaj rreziqeve që lidhen me mbrojtjen. Këto sisteme janë pjesë e mbrojtjes sociale dhe madje i kalojnë këta kufij. Në nivelin e parandalimit synimi i tyre ka të bëjë me mbështetjen dhe forcimin e familjeve për zvogëlimin e përjashtimit social dhe zvogëlimin e rreziqeve të ndarjes, dhunës dhe shfrytëzimit.

Mbledhja e të dhënave

Burimet për mbledhjen e të dhënave përfshinin kornizën afatmesme të shpenzimeve trevjeçare, buxhetin vjetor dhe dokumentet e tjera të sektorit. Kategoritë e shpenzimeve të cilat u përdorën në buxhetim përfshinin: (i) personelin e përfshirë në çështjet e mbrojtjes së fëmijëve, (ii) kostot operationale si mallrat dhe shërbimet, subvencionet dhe transfertat, shërbimet komunale dhe (iii) shpenzimet kapitale të lidhura me ndërtimet ekzistuese dhe të reja, investimet në teknologjinë informative, etj.

Për t'i identifikuar shpenzimet në kuadër të kategorive të përmendura, nën-këshilli e krijoi një diagram të strukturës organizative për secilin institucion të nivelit qendror dhe lokal, duke përfshirë shumicën e departamenteve më të rëndësishme që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve. Pastaj në kuadër të secilit departament u bë vlerësimi i përqindjes së kohës të cilin e dedikon personeli në mbrojtjen e fëmijëve në bazë të përshkrimit të punës dhe në bazë të rasteve të mbrojtjes së fëmijëve kundrejt rasteve të përgjithshme të trajtuara nga institucioni. U përdor logjika e njëjtë për t'i llogaritur kostot operationale dhe shpenzimet kapitale, ku këto të dhënat u morën nga dokumentet buxhetore dhe ato të kontabilitetit të institucioneve. Në fillim, u buxhetuan programet e secilit institucion, të cilat pastaj u mbledhën për ta dhënë pasqyrën e tërë sektorit.

Kufizimet në metodologji

Metodologjia e përdorur i shfaqti disa kufizime sa i përket cilësisë së të dhënave zyrtare ekzistuese dhe të njohurive dhe ekspertizës së zyrtarëve që ishin të angazhuar si burime gjatë procesit. Kjo zbrastësi ishte për shkak të numrit të kufizuar të studimeve në dispozicion që i trajtonin këto dukuri. Arsyeja e këtyre kufizimeve kryesisht është për shkak të kompleksitetit të vlerësimit, i cili përshinte sektorë të ndryshëm të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, duke përfshirë edhe departamente të ndryshme në kuadër të një institucioni, dhe të informacioneve si nga niveli qendror edhe ai lokal.

Për më tepër, vlerësimi kishte për synim të përfshinte informacione nga lloje të ndryshme të shërbimeve dhe të angazhimeve profesionale dhe fokusohej te grupe të ndryshme, duke përfshirë edhe komunitetet pakicë, të cilat i kemi përmendur më sipër. Megjithatë, meqë vetë pakoja e instrumenteve nuk përfshinte pyetje që lidheshin me ekzistimin e komuniteteve të ndryshme në Kosovë dhe për këtë rajon, pakoja e instrumenteve ka nevojë që në të ardhmen të përshtatet më mirë me kontekstin lokal.

Edhe pse një OJQ e komunitetit Rom-Ashkali dhe Egjiptian ishte e përfshirë në vlerësim, megjithatë, nuk kishte burime të mjaftueshme të informatave në dispozicion për përfshirjen e pikëpamjeve të komuniteteve të tjera si pjesë e një procesi më gjithëpërfshirës. Andaj është me rëndësi të theksohet se pakoja e instrumenteve duhet të përdoret në të ardhmen e afërt për vlerësimin e pikëpamjeve të sistemit sipas komuniteteve të veçanta në nivelin lokal. Kjo po ashtu ka të bëjë me vlerën e përdorimit të pakos së instrumenteve në të ardhmen si një mjet për vlerësim/hartëzim të vazhdueshëm, për planifikim, monitorim dhe vlerësim duke u bazuar në vlerësimin aktual si bazë fillestare.

Gjithashtu, pakoja e instrumenteve nuk e përshkruan ndonjë qasje të veçantë për përfshirjen e pikëpamjeve të fëmijëve në vlerësim. Andaj, në të ardhmen, pakoja e instrumenteve duhet të përshtatet më mirë për kontekstin vendor të Kosovës.

Në të njëjtën kohë disa prej këtyre pengesave u trajtuan duke dizajnuar instrumente shtesë metodologjike dhe duke organizuar aktivitete të ndryshme (p.sh., protokolle për mbledhjen e mendimeve të fëmijëve; intervistat gjysmë të strukturuar me zyrtarë dhe përfaqësues institucionesh të cilët nuk ishin të përfshirë në këshillin ndërqeveritar; takime me komunitetin e donatorëve në Kosovë, e të tjerë).

Sa i përket metodologjisë së zhvilluar nga nën-këshilli për mobilizimin e burimeve, puna në vlerësim kontribuoi pozitivisht pasi ndihmoi në identifikimin e kostove për kategori të ndryshme dhe mundësoi analizimin jo vetëm brenda një sektori, por në sektorë të ndryshme meqë kemi të bëjmë me një natyrë ndër-sektoriale të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve. Gjithashtu, kjo metodologji mundësoi mbledhjen e të dhënave nga buxheti i shtetit dhe programet e financuara nga donatorët në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve që mundësoi identifikimin e zbrastësirave (nëse ekzistonin) të financimit në këtë fushë. Së fundmi, metodologjia ndihmoi në vlerësimin e gjendjes aktuale buxhetore dhe ofroi një parashikim për pesë vjeçar in e ardhshëm, i cili mund t'ju shërbejë të gjitha palëve të përfshira të interesit, përfshirë edhe qeverinë, që ta kuptojnë ndarjen e fondeve në programet ekzistuese të mbrojtjes së fëmijëve dhe t'i krahasojnë ato me një vizion të mundshëm të përkufizuar për këtë fushë.

Një sfidë me të cilën u ballafaqua nën-këshilli për mobilizimin e burimeve ishte fakti se koncepti për mbrojtjen e fëmijëve është një koncept i ri për shumë institucione. Edhe pse të dhënat e mbledhura nga institucionet përkatëse ishin të besueshme që mbështeteshin

nga dokumente zyrtare buxhetore, ato nuk e pasqyrojnë në tërësi realitetin e buxhetimit për mbrojtjen e fëmijëve. Siç e kemi përmendur më parë, kjo ishte për faktin se nuk kishte ndonjë vijë të veçantë buxhetore për mbrojtjen e fëmijëve dhe se të dhënat e mbledhura shpesh bazoheshin në supozime, të cilat natyrisht se e sfidojnë saktësinë e tyre. Për më shumë, kufizimet buxhetore që vinin për shkak të mungesës së statistikave për kategoritë e fëmijëve që janë nën mbrojtjen sociale, si të fëmijëve të dhunuar, të abuzuar, të neglizhuar, etj., meqë këto të dhëna nuk raportoheshin gjithmonë, e madje edhe kur raportoheshin, nuk mund të identifikoheshin lehtë. Atëherë kur të krijohet nga qeveria një program i qartë për mbrojtjen e fëmijëve duhet të zhvillohet ushtrimi i njëjtë për buxhetim, dhe në këtë kuptim, ushtrimi për përcaktimin e kostos ishte një ushtrim i mirë për ndërtimin e kapaciteteve.

Në anën tjetër, të dhënat nga niveli lokal po thuaj nuk ekzistojnë, përveç për programet e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenie Sociale për vitet 2010-2011. Andaj, ky vlerësim nuk mund ta pasqyroj si duhet mbrojtjen e fëmijëve në nivelin lokal.

Të katër nënseksionet e më poshtme paraqesin të gjeturat kryesore dhe rekomandimet e hartuara nga secili prej katër nën-këshillave të cilat i kemi përmendur më lartë:

4. Sistemi i mirëqenies sociale, shëndetit dhe arsimit

Nënkëshilli për mirëqenie sociale, shëndetësi dhe arsim kishte për qëllim përcaktimin, vlerësimin dhe hartëzimin e çështjeve kryesore të mirëqenies sociale, duke përfshirë edhe përgjegjësitë e ministrive përkatëse, si MPMS³, MSH⁴, MASHT⁵, të cilat janë relevante për mbrojtjen e fëmijëve. Për ta arritur këtë qëllim, ky nënkëshill duhet t'i plotësonte me informacion instrumentet e mëposhtme⁶:

Instrumenti 1b:	Informacioni bazë dhe profili i rrezikut të vendit
Instrumenti 1d:	Konteksti ligjor dhe i politikave
Instrumenti 1e:	Të dhënat për vendimmarrje
Instrumenti 2a:	Struktura, funksionet dhe kapacitetet e sistemit
Instrumenti 2b:	Ministritë specifike
Instrumenti 2b (i):	Hartëzimi i ministrisë kryesore
Instrumenti 2b (ii):	Hartëzimi i ministrisë dytësore
Instrumenti 2b (iii):	Prioritetet e ministrisë
Seksioni 3:	Vazhdimi i kujdesit

Mbledhja e informacionit u arrit nëpërmjet organizimit të dy punëtorive me pjesëmarrjen e anëtarëve të nënkëshilleve, duke synuar:

- Të përshkruajë kontekstin e përgjithshëm në të cilin vepron sistemi i mbrojtjes së fëmijëve, duke përcaktuar çfarë ekziston dhe çfarë të dhënash mungojnë;
- Të paraqesë dispozitat kryesore të regjimit global të të drejtave të fëmijëve dhe të pasqyrojë aderimin e politikës kombëtare në këtë regjim;
- Të sigurojë informacion për të dhënat, analizat, kërkimet, komunikimet që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve, veçanërisht me mirëqenien sociale, shëndetin dhe edukimin;
- Të përcaktojë pikat e forta dhe pikat e dobëta në strukturat, kapacitetet dhe funksionet e sektorëve përkatës shtetërorë për mbrojtjen e fëmijëve;
- Të hartëzoj çdo ministri ose agjenci, e cila ka përgjegjësi kryesore në mbrojtjen e fëmijëve, veçanërisht për mirëqenien sociale, shëndetin dhe edukimin;
- Të përmbledh prioritetet e ndërtimit të sistemit;
- Të përshkruajë dhe vlerësojë vazhdimësinë e kujdesit dhe të identifikojë mangësitë e mundshme;
- Të krijojë një vizion për sistemin e mbrojtjes së fëmijëve në Kosovë duke hartuar një organogram “tipik” për sistemin e mbrojtjes së fëmijëve në nivel qendror dhe lokal.

3 Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale: <http://mpms.rks-gov.net>

4 Ministria e Shëndetësisë: <http://msh-ks.org>

5 Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë: <http://masht-gov.net>

6 Bashkësia e Instrumenteve përbëhet nga njëzet vegla të ndara.

4.1 Gjetjet kryesore

Bazuar në informacionet e mbledhura, në vijim janë gjetjet kryesore lidhur me sistemin e mirëqenies sociale, shëndetësisë dhe arsimit:

1. **Enti i Statistikave i Kosovës nuk siguron të dhëna statistikore të plota dhe të përditësuara në lidhje me indikatorët e përdorur në mënyrë botërore, të cilat shërbejnë për të vlerësuar situatën e mbrojtjes së fëmijëve në një vend.** Gjithashtu, nuk ekzistojnë statistika në lidhje me grupe të caktuara fëmijësh, të cilët përbëjnë subjekte të një mbrojtje të veçante si p.sh fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët e minoriteteve, fëmijët e rrugës apo për punën e fëmijëve në shkallë vendi, fëmijët e prekur nga HIV/AIDS, etj.
2. **Të dhënat mbi mbrojtjen e fëmijëve në dispozicion, janë të fragmentarizuara dhe grumbullohen, analizohen dhe shkëmbehen vetëm në nivel institucional e jo në atë multi-sektorial.** Mungon një bazë unike e të dhënave dhe gjithëpërfshirëse për fëmijët e abuzuar, të dhunuar apo të neglizhuar, e cila do të përfshijë të dhënat nga MPMS përfshirë Qendrat për Punë Sociale në nivel komunal, të dhënat nga Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial dhe të dhënat nga Policia. Në të njëjtën mënyrë mungon një bazë e të dhënave gjithëpërfshirëse për fëmijët në konflikt me ligjin pasi secili institucion (Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Ministria e Drejtësisë, Policia e Kosovës, Shërbimi Sprovues i Kosovës, Organi i Kujdestarisë,) prodhon të dhënat e tij, të cilat duhet të harmonizohen në një sistem të vetëm.
3. **Në përgjithësi, në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, mungon mekanizmi ndër-institucional i dokumentimit të personit raportues të dhunës, duke përfshirë vetë-raportimin e dhunës nga fëmijët.** Pra, nuk ka një formë standarde apo formular raportimi, i cili do të përdoret nga profesionistët apo personat e tjerë. Për më tej, në përgjithësi evidentohet se mungon një vet ndërgjegjësim i fëmijëve për të raportuar dhunën, abuzimin dhe neglizhimin. Ky fakt gjithashtu evidentohet, edhe nga studimi “Hulumtim mbi dhunën ndaj fëmijëve në shkollat e Kosovës,” UNICEF 2005, i cili ka synuar matjen e aftësisë jetësore të fëmijëve për të njohur dhunën dhe format e saj, për ta raportuar atë dhe për mënyrat e kërkimit të mbrojtjes.
4. **Çështjet e riintegritimit të fëmijëve, viktimat e dhunës nuk gjejnë pasqyrim siç duhet në ligjin kundër dhunës në familje dhe në përgjithësi riintegrimi nuk realizohet në mënyrë të koordinuar në praktik.** Megjithatë, vlen të përmendet se Agjencia për barazi gjinore në Zyrën e Kryeministrit është në fazën e hartimit dhe miratimit të Strategjisë nacionale kundër dhunës në familje dhe planit të veprimit 2010-2013, w cila me hyrjen në fuqi të Ligjit “Për mbrojtjen nga dhuna në familje” do të titullohet “Programi Nacional për mbrojtjen nga dhuna në familje” dhe do të shtrihet për periudhën kohore 2011-2014. Misioni i programit është të krijojë mekanizma efektiv për parandalimin, mbrojtjen, trajtimin, rehabilitimin dhe integrimin e viktimave të dhunës. Ndërkohë që, përkrahja dhe trajtimi do të jetë shtylla e tretë e Strategjisë, në kuadër të së cilës do të identifikohen dhe ofrohen forma veprimi me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për përkrahjen e viktimave të dhunës në familje, trajtimin profesional të kryerësve dhe abuzuesëve të dhunës në familje deri në integrimin e plotë të tyre në jetën normale.
5. **Rezultoni se korniza ligjore lidhur me mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë është e harmonizuar me konventat ndërkombëtare,** duke pasur parasysh faktin se legjislativi i Kosovës është i ri dhe është bazuar në modelet më të zhvilluara ligjore.

6. **Megjithëse, ekziston një version i Strategjisë Kombëtare për Punën e Fëmijëve, gjithsesi puna e fëmijëve ende mbetet problem në vend, veçanërisht raportimi i punësimit informal.** Puna e fëmijëve vërehet të jetë në përgjithësi informale ose të kryhet në kushtet e punës së fëmijëve në rrugë, sikurse ka edhe një angazhim informal të fëmijëve në punë të ndryshme, duke përfshirë edhe punën në bujqësi. Legjislacioni i punës, duke përfshirë mekanizmat e ngritura për mbrojtjen e fëmijëve nga punët e këqija dhe të rënda si dhe sistemi ligjor i ankimit, janë të pazbatueshëm pasi ky legjislacion i referohet vetëm punësimit formal. Megjithatë, në kuadër të aktiviteteve parandaluese për punën e fëmijëve, evidentohen përpjekje pozitive. Këtu mund të përmendim miratimin e vendimit nr. 6/2005, i cili themelon Këshillin e Kosovës mbi Parandalimin dhe Eliminimin e Formave të Rënda të Punës së Fëmijëve. Ky këshill vepron në nivel kombëtar dhe vendos politikat dhe prioritetet programore për mbrojtjen e fëmijëve nga format e rënda të punës, dhe ka për detyrë të monitoroj situatën e punës së fëmijëve në vend dhe të koordinojë veprimet kundër saj. Gjithashtu, një iniciativë e mirë në këtë drejtim, e cila rekomandohet të shtrihet në gjithë komunat e Kosovës, është ngritja e Këshillave Lokale të Veprimit (KLV) për parandalimin e punëve të fëmijëve, të ngritura vetëm në 6 komuna. Gjithashtu vlen të theksohet se, Instituti i Politikave Sociale (IPS), gjatë vitit 2010 ka nënshkruar memorandume mirëkuptimi me 25 kryetarë të komunave të Kosovës për themelimin e KLV.

Gjithashtu, ka disa akte nënligjore të cilat rregullojnë punën e fëmijëve në përgjithësi, të tilla si: (1) Hartimi i listës me format e rrezikshme të punëve në bujqësi. Përpos kësaj liste, edhe Ligji Nr. 03/L-40 “Për Përdorimin apo tregtimin e pesticideve”, edhe pse ka një tjetër fokus, përmban dispozita të cilat ndalojnë shitjen, shpërndarjen si dhe furnizimin me pesticide për personat më të ri se 18 vjeç. (2) Janë nënshkruar memorandume mirëkuptimi për bartjen e përgjegjësive, në kuadër të së cilave MBPZHR-ja merr përsipër një pjesë të përgjegjësisë në inspektimin e punëve të rrezikshme për fëmijët në sektorë të caktuar. (3) Lista për punët e rrezikshme të fëmijëve, e miratuar nga Qeveria, (Udhëzim 17/2008 “Për parandalimin dhe eliminimin e punëve më të rrezikshme për fëmijët në Kosovë”). (4) Versioni i “Strategjisë për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve 2013-2016”. Gjithashtu, Qeveria e Kosovës dhe UNMIK kanë shprehur përkushtimin për eliminimin e punës së fëmijëve me nënshkrimin e memorandumit të mirëkuptimit me ILO mbi implementimin e Programit Ndërkombëtar të ILO-s mbi Eliminimin e Punës së Fëmijëve (IPEC).

7. **Në lidhje me funksionimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, koherenca e veprimeve dhe koordinimi ndër-institucional nuk janë në nivele të kënaqshme.** Megjithë ekzistencën e një marrëveshje mes MPMS, MSH, MASHT dhe Policisë së Kosovës për mbrojtjen e fëmijëve, përsëri mungon një referim i qartë institucional. Në këtë kuadër, mandatet e specialistëve të ministrive apo institucioneve, në nivel qendror dhe lokal, nuk janë të qarta në lidhje me referimin apo raportimin e rasteve të identifikuar të fëmijëve tek institucionet përkatëse, bazuar në format unike të raportimit/referimit. Gjithashtu, mungojnë protokollat dhe formularët e dokumentimit, të identifikimit dhe referimit institucional dhe ndër-institucional. Pavarësisht se, identifikimi dhe referimi është detyrim ligjor i të gjithë zyrtarëve institucional, mos ekzistenca e këtij detyrimi në përshkrimet e punës së tyre, e bën këtë detyrim të mbetet deklarativ dhe jo i zbatuar në praktikë. Megjithatë, ekziston Doracaku për Mbrojtjen e Fëmijëve (i hartuar në bashkëpunim ndërmjet MPMS dhe UNICEF), i cili siguron informacion në lidhje me identifikimin e shenjave të abuzimit, dhunës dhe neglizhimit, si dhe përcakton udhëzime për veprime të cilat duhet të ndërmerren nga punonjësit socialë, personeli mjekësor, zyrtarëve policorë si dhe mësimdhënësit, në rast të identifikimit të fëmijëve të abuzuar apo neglizhuar.

Megjithatë, nuk ka protokolle standarde mbi bazën e të cilave secili nga këto institucione do të bëj trajtimin dhe menaxhimin e rasteve të sipërpërmendura të fëmijëve. Nga ana tjetër, ligji nuk parashikon dispozita për kategorinë e fëmijëve në rrezik apo fëmijët dëshmitarë të dhunës, që është shumë e rëndësishme për parandalimin e abuzimit dhe dhunës ndërmjet fëmijëve.

Vlen të theksohet se, në nivel lokal, ekziston një qasje multidisiplinare në shërbimet për fëmijët, të cilat ofrohen kryesisht nga QPS-të. Megjithatë, është e nevojshme që, në nivel lokal, të ketë një koordinim më të mirë ndërmjet institucioneve kryesore. Në këtë aspekt, është e nevojshme ngritja e një strukture përgjegjëse për koordinimin e veprimeve të nevojshme ndërmjet institucioneve mbi bazë rasti. Në këtë kuadër, vlen të përmenden modelet e koordinimit në nivel lokal si:

- a. Modeli i Task Forcës: task forcat, të cilat janë ngritur në 6 komuna, bazuar në Projektin “Ngritja e një Sistemi të Mbrojtjes së Fëmijëve,” zbatuar nga Terre des hommes dhe UNICEF dhe që synon forcimin e menaxhimit të rasteve dhe krijimin e një praktike të mirë në këtë drejtim. Task forca ka përfaqësues nga njësitë për të Drejtat e Njeriut, Policia, Mbrojtësi i viktimave, Njësia për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Policia në Komunitet, Shërbimi Sprovues i Kosovës, Departamenti Komunal i Arsimin dhe Departamenti Komunal për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Megjithatë, një mekanizëm referues si Task forca, e ngritur nga shoqëria civile, nuk garanton qëndrueshmëri të lartë, prandaj këto shërbime duhet të ofrohen nga qeveria dhe se është e nevojshme që strukturat komunale të institucionalizojnë modele të këtylla të ofrimit të shërbimeve. Në këtë kuadër, duhet të krijohet një fond social në rritjen e garancive afatgjata të ofrimit të shërbimeve dhe forcimi i rolit të punonjësve socialë.
 - b. Modeli GVK: Ngritja e Grupeve të Veprimit të Komunave (GVK) në Prizren dhe Gjilan është pilotuar si një model i ri i mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve, i parashikuar në kuadër të “Programit në Përgjigje të Trafikimit të Fëmijëve” dhe i mbështetur nga Save the Children. Këto grupe përbëhen nga përfaqësues të Policisë dhe të sektorit të Mirëqenies Sociale, Koordinatorit për të Drejtat e Fëmijëve, Qendrat për të Rinj, OJQ lokale, Shërbimi Sprovues, Mbrojtësit e viktimave dhe përfaqësuesit e shkollave. Qëllimi është koordinimi i përpjekjeve për të vepruar dhe koordinuar veprimet në nivel komunal, në lidhje me shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve, për fëmijët në rrezik dhe adoleshentët, me qëllim parandalimin e dhunës, shfrytëzimit, abuzimit si dhe minimizimi i migrimit të pasigurt të fëmijëve dhe rrezikun e trafikimit.
8. **Edhe pse ligjet vendore sanksionojnë dhunën, evidentohet se ka raste që ndëshkimi trupor konsiderohet si mjet edukimi dhe disiplinimi për fëmijët, si brenda familjes ashtu edhe në shkollë.** pavarësisht faktit se ekzistojnë rregullore të brendshme të shkollave, të cilat parashikojnë masa për parandalimin e përdorimit të dhunës fizike dhe psikologjike, të cilat cenojnë integritetin e fëmijës. Nga ana tjetër, shërbimi psikologjik ofrohet në 85 shkolla, me mundësi shtrirje në të gjitha shkollat e Kosovës dhe të dhënat tregojnë se ka një rritje të numrit të rasteve të raportuara të dhunës në familje si dhe një rritje e vetëdijesimit të shtetasve në lidhje me përdorimin e mekanizmave ligjore mbrojtës në këtë aspekt. Kështu, bazuar në të dhënat e Departamentit të Inspektimit dhe Komisionit të Ankesave, në MASHT, brenda vitit 2010 janë trajtuar gjithsej 9 (nëntë) raste të raportuara të dhunës së ushtruar nga mësuesit ndaj nxënësve, 2 (dy)

raste për abuzim seksual dhe 7 (shtatë) raste për dhunë fizike, për të cilat janë marrë masat e nevojshme të parashikuara me ligj. Megjithatë, pavarësisht shifrave të dhëna vazhdon të mbetet problem mungesa e formave unike të raportimit të dhunës në shkolla dhe në familje, e cila do të lehtësonte identifikim dhe referimin e rasteve.

9. **Në përgjithësi evidentohet mungesa e aftësisimit apo ngritja e kapaciteteve të profesionistëve, veçanërisht në fushën e shërbimeve sociale** - evidentohet nevoja e aftësisimit të vazhdueshëm profesional të nëpunësve të shërbimeve sociale e familjare. Gjithashtu, në Kosovë nuk ka një fakultet për punonjës social dhe ligji ka parashikuar se profilet që mund të punojnë në shërbime sociale mund të jenë: juristët, sociologët punëtorët social, psikologët, dhe pedagogët. Kjo argumentohet me faktin se shërbimet sociale në Kosovë bazohen në punën ekipore dhe multidisiplinare. Megjithatë, në praktikë duhet të merren parasysh nevojat për diversitet të profesionistëve që formojnë ekipin për menaxhimin e rastit. Menaxheri i rastit, i cili mund të jetë jurist, punëtor social, psikolog, pedagog, apo sociolog, harton planin e punës dhe bazuar në nevojat e rastit formon ekipin me profesionistë të ndryshëm. Në këtë kuadër, çdo komunë duhet të ketë parasysh nevojat e qendrës kur nxjerr njoftimin dhe konkursin për një vend të lirë pune.

Në përgjithësi, profesionistët e angazhuar në shërbimet sociale janë trajnuar e certifikuar për “Menaxhimin Modern të Rastit”, përmes një projekti të Bankës Botërore, i cili është realizuar nga kompania finlandeze “Grupi Konsultativ i Helsinkit”. Megjithatë, me qëllim të ndjekjes së trendëve të reja që aplikohen në fushën e shërbimeve sociale e familjare, duhet të organizohen trajnime të vazhdueshme dhe adekuate

10. **Ekziston një qasje multidisiplinare për trajtimin e rasteve brenda QPS’ve, por mungon një mekanizëm koordinues për të angazhuar në mënyrën e duhur shërbimet e tjera të nevojshme të cilat nuk mund të përballohen nga ekipi i QPS.** Në përgjithësi, QPS bashkëpunon me pjesën më të madhe të institucioneve në nivel lokal, të tilla si: Mbrojtësi i Viktimave, Drejtoritë Komunale të Arsimit, Policia etj. Megjithatë nuk ka një strukturë, e cila do ta lehtësonte koordinimin. Ky koordinim realizohet, kryesisht, mbi baza të projekteve si p.sh: projekti pilot për krijimin e task forcave, i zbatuar me mbështetjen e Terre des Homes, UNICEF, ECLO dhe partnerë të tjerë në 6 (gjashtë) komuna të Kosovës. Ky projekt raportohet dhe konsiderohet si një praktikë dhe model i mirë.
11. **Ekziston legjislacioni ndëshkues sipas Kodit Penal për veprat penale si abuzimi apo shfrytëzimi seksual. Është i nevojshëm hartimi i udhëzimeve administrative që i përcaktojnë procedurat e rehabilitimit, risocializimit dhe riintegritit të fëmijëve në familje dhe shoqëri.** Po kështu, mungojnë protokollet standarde për trajtimin e duhur të rasteve dhe dhënien e shërbimeve, të detyrueshme për çdo profesionist të përfshirë në mbrojtjen e fëmijëve. Megjithatë, me qëllim të parandalimit vlen të përmendet se temat mbi shfrytëzimin/keqpërdorimin janë të integruara në planprogramet shkollore. Në ndërkohë janë realizuar një varg trajnimesh të mësuesve lidhur me këto tema, që kanë lidhje me mbrojtjen e fëmijëve dhe identifikimin e shenjave të abuzimit. Këto trajnime zhvillohen në 5 nivele, dhe mësuesit certifikohen për secilin nivel.
12. **Bazuar në informacionet e vlerësimit, rezulton se Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë ka ngritur një Grup për të Drejtat e Fëmijëve (aktualisht punon një person), por evidentohet një mos informim i mjaftuar nga ana e popullatës në lidhje me funksionin e Avokatit të Popullit.** Kjo është arsyeja përse ankesat e paraqitura nga fëmijët rezultojnë të jenë të ulëta. Gjithashtu, ka kufizime financiare të vet këtij institucioni për të ndërmarrë iniciativa në fushën e mbrojtjes së fëmijëve. Nga ana tjetër, kufizimet

financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit kanë një ndikim të madh në pavarësinë e funksionimit të këtij institucioni. Rezulton se institucioni bashkëpunon, mes tjerash, edhe me QPS, Mbrojtësin e Viktimave dhe Komisionin e Ndihmës Juridike në Kosovë për të referuar rastet bazuar në ankesat e paraqitura nga qytetarët, të cilat shërbejnë gjithashtu edhe për fëmijët. Megjithatë nuk ka marrëveshje bashkëpunimi institucionale në këtë drejtim dhe për këtë arsye është e nevojshme që një bashkëpunim i këtillë të vendoset edhe ligjërisht.

13. **Ekziston detyrimi me ligj në Kosovë për të marrë mendimin e të rinjëve gjatë hartimit të legjislacionit të rëndësishëm për fëmijët**, sipas ligjit “Për fuqizimin dhe pjesëmarrje të rinjve” 03/L-145. Në lidhje me çështjet e mbrojtjes së fëmijëve, rezulton të ekzistojnë si mekanizma edhe këshillat e nxënësve në arsimin parauniversitar. Megjithatë është i nevojshëm forcimi i kësaj strukture dhe konsiderimi i duhur i mendimit të fëmijëve gjatë procesit të hartimit të legjislacionit. Kështu, vlen të përmendet si praktikë e mirë në këtë drejtim, përfaqësimi i fëmijëve edhe në Këshillin Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijëve pasi që dy fëmijë janë anëtare të këtij këshilli.
14. **Rezulton se trajnimet e bëra deri më tani për profesionistët dhe punonjësit e ndryshëm të administratës shtetërore kanë qenë spontane dhe jo të dedikuara në lidhje me çështjet e mbrojtjes së fëmijëve**. Krahas faktit se këto trajnime kanë synuar në radhë të parë rritjen e nivelit profesional, ato kanë ndihmuar, gjithashtu, edhe në rritjen në një masë të caktuar të kapaciteteve të punonjësve për t’i trajtuar më mirë çështjet e mbrojtjes së fëmijëve. Këto trajnime janë ofruar në bashkëpunim me OJQ vendore si dhe ato ndërkombëtare. Megjithatë, është e nevojshme të ketë programe të qarta për trajtimin e temave në lidhje me çështje kyçe të mbrojtjes së fëmijëve sipas këndvështrimit të profesionistit apo rolit që ai ka për shkak të funksionit publik që kryen. Kështu p.sh. mungojnë programe trajnimi mbi çështjet dhe menaxhimin e rasteve të mbrojtjes së fëmijëve, për mjekët dhe infermieret, për mësuesit, për punonjësit socialë të QPS, për zyrtarët e Njësisë për të Drejtat e Njeriut në ministri dhe komuna, për avokatët, policët, për mbrojtësit e viktimave. Krahas punonjësve të MPMS, zyrtarë që ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta (QPS, DKA, DSHMS, NJDNJ, etj) kanë nevojë të vazhdueshme për trajnime në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve.
15. **Deri në fund të vitit 2010, birësimi realizohej përmes një procedure administrative, i cili kishte si parim udhëheqës dhe konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës**, fakt i cili evidentohet gjithashtu nga studimi i OSBE-s “Procedura e birësimit në Kosovë, 2010”. Kështu më konkretisht, vlerësimi i fëmijës si dhe i aplikuesve birësues bëhet nga QPS. Në këtë kuadër theksohet se MPMS harton politikat e birësimit dhe ka mandatin kryesor për monitorimin e standardeve. Gjithashtu, duhet theksuar se janë aprovuar standardet për birësimin e fëmijëve. Ndërkohë, duhet theksuar se duke filluar nga Janari i vitit 2011, birësimi i fëmijëve bëhet me vendim gjyqësor dhe në këtë kuadër është e nevojshme të përcaktohet se si do të realizohet koordinimi ndërmjet gjykatës dhe QPS në një procedurë të tillë.
16. **Rezulton se ka një mungesë të numrit të familjeve strehuese pritëse dhe të strukturave mbështetëse për referimin e fëmijëve në raste të emergjencës**. Megjithatë, duhet theksuar se QPS-të kanë tashmë një praktikë të konsoliduar për vendosjen e fëmijëve në strehim familjar, e cila duhet të inkurajohet jo vetëm për rastet e kujdestarisë me afat të gjatë por edhe për rastet emergjente. Rezulton se familjet strehuese nuk paguhën mirë, kryesisht në rastet e fëmijëve me aftësi të kufizuara, pasi deri më tani ligji nuk bën ndonjë diferencë për masën e pagesës së shërbimit të strehimit familjar në bazë të nevojave të fëmijës. Gjithashtu, në këtë aspekt, është e rëndësishme të forcohet

roli mbikëqyrës i organit të kujdestarisë në lidhje me rritjen e numrit të vizitave periodike për fëmijët e vendosur në strehim familjar apo rezidencial.

Në këtë kuadër është e nevojshme vendosja në dispozicion të mjeteve të transportit për QPS, të cilat do të garantonin rritjen e efikasitetit në kohë për monitorimin e situatës së fëmijëve të vendosur në strehim familjar, duke pasur parasysh vendosjen gjeografike të familjeve strehuese. Gjithashtu, vendimmarrja për të përzgjedhur familjen strehuese duhet të bëhet duke marrë në konsideratë përkatësinë fetare të fëmijës, origjinën e tij apo prejardhjen kulturore dhe duke e përshtatur atë me familjen strehuese.

17. **Rintegrimi shoqëror e komuniteteve pakicë mbetet sfida për Kosovën.** Megjithatë janë bërë përpjekje për të ulur këtë dukuri tek fëmijët e këtyre komuniteteve. Psh: MASHT ka krijuar lehtësira për integrimin e fëmijëve të komuniteteve jo shqiptare në arsimin e mesëm duke hequr si kriter regjistrimin e tyre në klasën e 10 me arritjen e pikëve të nevojshme gjatë testimit. Vlen të përmendet gjithashtu hartimi i kurrikulës në gjuhën rome, e cila përfshinë edhe historinë e komunitetit RAE. Ekziston edhe Strategjia Kombëtare për Integrimin e Komunitetit RAE në gjuhën Rome. Gjithashtu, përmendim projektin 2 vjeçar të MASHT “Shkrim dhe lexim bazik për 60 gra dhe vajza të komunitetit RAE”, i cila ka pasur si synim të siguroj programe të përshpejtuara për mësimdhënie, përmes ngritjes së klasave të integruara për fëmijët, të cilët nuk ndiqnin rregullisht programin shkollor.
18. **Martestat e hershme nën moshën e përcaktuar me ligj paraqesin një praktikë kulturore të përhapur, veçanërisht në komunitetin RAE.** Fenomeni i martesave të hershme shoqërohet me faktin se vajzat kanë përfunduar arsimin e detyruar dhe për këtë arsye konsiderohet se janë në moshën e duhur për martesë. Zakonisht, janë prindërit që lidhin këto martesat përkundër faktit se kjo është në kundërshtim me ligjet e aplikueshme në Kosovë . Gjithashtu, një numër i madh martesash lidhen me qëllim që të sigurohen dokumentet e nevojshme për të jetuar jashtë shtetit (si synim dhe prirje parësore e të rinjve për të migruar në vendet e zhvilluara perëndimore) apo për shkak të shtatzënisë së hershme të vajzave.
19. **Situata e fëmijëve në rrugë evidentohen si situatë problematike, për shkak të prezencës së fenomenit të lypjes, punës së fëmijëve, braktisjes së shkollës, trafikimit të fëmijëve (brenda dhe jashtë Kosovës).** Në përgjithësi, fenomeni i lypjes është i detyruar nga të rriturit ose prindërit. Megjithatë, ka gjithashtu fëmijë, të cilët lypin jo sepse janë të detyruar, por për shkak të mungesës së mjeteve të jetesës, dhe duke qenë se vijnë nga familje të varfëra. Zakonisht këta fëmijë kanë nivel të ulët arsimor, përkujdesje të ulët prindërore apo mungesë të kujdesit prindëror. Populli i Kosovës i mëshiron fëmijët të cilët lypin dhe si rrjedhim inkurajojnë këtë fenomen, i cili kthehet në një aktivitet fitimprurës. Fenomeni i lypjes është më shumë i përhapur në komunitetin RAE dhe në disa raste ka edhe elementë ndërkuftar. Këto janë raste të fëmijëve që vijnë nga Shqipëria dhe shpesh shoqërohen me elementë të trafikimit. Në këtë kuadër, janë bërë disa studime si psh: Raport vëzhgimi: «Shfrytëzimi i fëmijëve shqiptare nga Shqipëria në situatë rruge në Kosovë» nga Terre des hommes, dhjetor 2010, nga i cili ka rezultuar se fëmijët shqiptarë të identifikuar duke lypur në rrugët e Kosovës janë të ekspozuar ndaj formave të ndryshme të dhunës, përfshirë neglizhencën dhe keqtrajtimin, abuzimin fizik dhe emocional, qasje të kufizuar në kujdesin shëndetësor bazë apo në shkollë, etj.
20. **Regjistrimi i lindjeve në Kosovë është i rregulluar mirë dhe realizohet përmes një sistemi funksional.** Kjo edhe për shkak të pranisë së zyrave të gjendjes civile pranë 6 spitaleve rajonale si dhe për faktin se procedurat administrative për regjistrimin e lindjes janë të lehta, veçanërisht në rastin kur lindja ndodh në spital dhe me posedimin e një

raporti mjekësor. Në rastet kur lindja ndodh jashtë spitalit, procedura parashikon nevojën e dy dëshmitarëve dhe nuk ka asnjë detyrim pagese shtesë. Megjithatë, studimi i UNICEF “Çdo fëmijë vlen: Regjistrimi i lindjeve në Kosovë”, dhjetor 2007- korrik 2008 tregon se situata në praktikë është pak më ndryshe duke sjellë të dhëna si psh: 8.3% e ekonomive familjare në Kosovë nuk kanë bërë regjistrimin e lindjes së fëmijëve të tyre nën moshën 18 vjeç etj. Gjithashtu, përmendim se projektligji për “Gjendjen Civile”, i cili do të miratohet së shpejti, parashikon sanksione financiare në rast të mosregjistrimit të lindjes brenda afatit ligjor të përcaktuar. Aktualisht, bazuar në praktikën e deritanishme, afati për regjistrimin e lindjes është 30 ditë dhe nuk shoqërohet me kryerjen e ndonjë pagese. Ndërkohë që, në praktikë mbetet problematike administrimi i tarifave të ndryshme në komuna të ndryshme për tërheqjen e certifikatës së lindjes apo dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin e lindjes.

Një problem tjetër është çështja e komuniteteve të zhvendosura, për të cilët procedurat administrative janë tejet komplekse dhe nuk paraqesin fleksibilitet. Kjo edhe për faktin se në shumë raste prindërit nuk kanë dokumentacionin e nevojshëm, i cili vërteton lindjen. Gjithashtu, problem mbetet regjistrimi i lindjeve jashtë shtetit, sidomos në ato raste kur ata ose prindërit e tyre riatdhesohen dhe nuk mund të pajisen me dokumentacionin e nevojshëm. Për këtë arsye duhet të merren masa për ngritjen dhe lehtësimin e procedurave administrative për regjistrimin e lindjeve.

21. **Rezulton se ka një iniciativë për krijimin e një mekanizmi ndërinstytucional për çështjet e torturës,** bazuar në Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së kundër Torturës. Kjo strukturë duhet të jetë përgjegjëse për të kryer inspektime të pavarura në vendet e vuajtjes së dënimit duke përfshirë burgjet, paraburgimet, qendrat për të mitur, stacionet policore, qendrat e migracionit dhe të gjitha vendet e tjera ku mbahen personat e privuar nga liria. Rezulton se Avokati i Popullit është duke punuar në këtë drejtim, në bashkëpunim me aktorët relevant që janë aktiv në këtë fushë. Grupi punues i përbër nga zyra e Avokatit të Popullit dhe aktorët e tjerë reevant kanë pasur takime preliminare. Deri më tani, ky grup punues me mbështetje të OSBE-s ka mbajtur disa takime pune dhe ka përgatitur marrëveshjen e bashkëpunimit e cila pritet të nënshkruhet së shpejti. Më 11 maj 2011 institucioni i Avokatit të Popullit, Qendra për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës dhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit për monitorimin e vendeve ku personat janë të privuar nga liria. Marrëveshja shënoi hapin e parë drejtë themelimit të mekanizmit transparent, të qëndrueshëm dhe të rregullt për monitorimin e këtyre qendrave me qëllim të parandalimit të torturës, keqtrajtimit dhe ndëshkimit të mundshëm. Sipas kësaj marrëveshje, bashkëpunimi përveç tjerash do të fokusohet në planifikimin dhe organizimin e vizitave të përbashkëta monitoruese, dhënien e propozimeve për ndryshimin në strukturat organizative të institucioneve që monitorohen, për ndryshimin në legjislacion dhe për përcaktimin e modelit të mekanizmit parandalues kombëtar.

4.2 Rekomandime

4.2.1 Rekomandimet për të forcuar kornizën ligjore dhe politike në mbrojtjen e fëmijëve:

- **Rekomandohet të amandamentohet “Strategjia për të Drejtat e Fëmijëve dhe Plani i Veprimit 2009 – 2013”, për të pasur një kapitull më vete për Mbrojtjen e Fëmijëve.** Megjithëse kjo strategji ka trajtuar çështje në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve në kapituj të ndryshëm të saj, si p.sh në kapitullin për Mirëqenie Sociale dhe në atë të Drejtësisë për të Mitur, është e rëndësishme që prioritetet e dala nga vlerësimi të vendosen në një kapitull më vete, pasi synimi i përcaktimeve në këtë kapitull është fuqizimi i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në mënyrë të koordinuar duke pasur parasysh grupet e fëmijëve si (viktima të abuzimit, neglizhimit apo dhunës dhe dëshmitarë). Për më tej sugjerohet të bëhen ndryshimet e duhura në Kapitullin e Drejtësisë për të Mitur duke reflektuar rekomandimet e bëra në këtë drejtim nga nën-Këshilli i Drejtësisë dhe Sigurisë (Shih rekomandimet në pikën 2.2 me poshtë) me qëllim unifikimin, pasjen e një legjislacioni koherent dhe plotësues ndërmjet fushave dhe institucioneve të ndryshme. Në këtë kuadër rekomandohet hartimi i një pjese të legjislacionit, i cili i dedikohet mbrojtjes së fëmijëve. Për më tepër, Strategjia për të Drejtat e Fëmijëve e rishikuar, duhet të harmonizohet me Strategjitë Sektoriale, pasi punonjësit e institucioneve të ndryshme shtetërorë priren t'i zbatojnë ato më lehtë, për shkak të mandatit të punës së tyre.
- **Rekomandohet të amandamentohen një sërë ligjesh, apo të nxirren aktet nënligjore përkatëse, për të siguruar mbrojtjen më efikase të fëmijëve. Kështu do të renditnim:**
 1. Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore për të shkurtuar procedurat e regjistrimit të lindjeve (gjetja nr. 20);
 2. Rishikimi i legjislacioni të punës dhe harmonizimi i tij me Konventën e ILO-s në lidhje me punësimin informal të fëmijëve. Më konkretisht, Ligji i Punës nr. 03/L-212, duhet të amandamentohet në lidhje me implementimin e mekanizmit mbrojtës për fëmijët që punojnë, duke përfshirë raste të punësimit informal (fëmijët të cilët punojnë në rrugë) si dhe në lidhje me mekanizmat e ankimit të krijuara veçanërisht për fëmijët. Ndërkohë, është e nevojshme aprovimi i Udhëzimit “Krijimi i ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes së shkollës nga nxënësit” nga MASHT, si dhe aprovimi i Strategjisë për Parandalimin dhe Eliminim e Punëve të Fëmijëve 2010-2016 nga MPMS; (gjetje nr.6).
 3. Rishikimi i legjislacionit me qëllim që ligji të mundësojë një shumëllojshmëri të profesioneve që bëjnë pjesë në QPS duke siguruar në këtë mënyrë një diversitet të profesionistëve, të cilët formojnë ekipin për menaxhimin e rastit. Gjithashtu, duhet t'i jepet prioritet personave me formim të punonjësit social dhe përzgjedhjes së tyre ndërmjet profesionistëve të tjerë për kryerjen e punës si punonjës sociale. (gjetje nr. 9)
 4. Është e nevojshme hartimi i udhëzimeve administrative që i përcaktojnë procedurat për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi, shfrytëzimi seksual, si dhe të miratohen protokollat standarde përkatëse, të cilat garantojnë mbrojtjen dhe adresimin e duhur me shërbime për fëmijët e shfrytëzuar. Megjithatë, vlen të përmendet se bazuar në Programin Nacional për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, synim

mbetet ndërtimi dhe fuqizimi i kapaciteteve të punonjësve të shëndetësisë, të shërbimeve sociale, për ofrimin e shërbimeve viktimave të dhunës në familje dhe në këtë kuadër parashikohet hartimi i një protokollit mjekësor të trajtimit të viktimave të dhunës në familje si dhe hartimi i procedurave standarde për trajtimin e viktimave të dhunës (gjetje nr.11)

5. Të miratohen udhëzime të detajuara apo procedura standarde të veprimit për policinë, prokurorinë, gjykatën, punëtorët socialë apo mbrojtësit e viktimave për trajtimin e fëmijëve viktimë të abuzimit dhunës apo neglizhimit. Kjo është e rëndësishme edhe në kuadër të Programit Nacional kundër dhunës në familje që synon rritjen e qasjes në shërbime për viktimat e dhunës në familje, me qëllim parandalimin e dhunës, mbrojtjen e viktimave dhe ndëshkimin e rehabilitimin e dhunuesve, si dhe të ngrihen programe të trajtimit afatgjatë për viktimat e dhunës deri në ri-integrimin e tyre të plotë në jetën normale (strehim, punësim mbrojtje ligjore mbështetje psiko-sociale) (gjetje nr. 7)
6. Plotësimi me akte nënligjore ose amandamentimi i Ligjit Nr. 03/L-182 për “Mbrojtjen nga Dhuna në Familje” në mënyrë që të parashikohet parimi dhe mekanizmi për referimin dhe riintegrimin e fëmijëve viktimë dhe fëmijëve në rrezik si dhe hartimi i akteve nënligjore të nevojshme për implementimin e tij. (gjetje nr.4).

4.2.2 Rekomandimet lidhur me përmirësimin e zbatimit të ligjeve dhe politikave:

- **Është e nevojshme të ndërmerren të gjitha masat për licencimin adekuat të profesionistëve që ofrojnë shërbime sociale.** Deri më tani, situata rezulton të jetë, që i vetmi certifikim i kësaj kategorie punonjësish është bërë në bazë dhe për shkak të një projekti tre-vjeçar të mbështetur nga Banka Botërore. (gjetje nr.9).
- **Çështje të implementimit të ligjit në mënyrë unike për regjistrimin e lindjeve:**
 - a Të standardizohen dispozitat ligjore për regjistrimin e lindjeve duke marrë parasysh dallimet ndërmjet komunave dhe tarifave të ndryshme që aplikohen për të marrë certifikatën e lindjes apo dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin e lindjeve.
 - b Realizimi i fushatave të vetëdijesimit për popullsinë në lidhje me nevojën për regjistrimin e lindjeve, si dhe parashikimi i procedurave lehtësuese, veçanërisht për fëmijët e lindur jashtë shtetit, të cilët dëbohen nga vendet ku kanë lindur fëmijët dhe nuk kanë më mundësi të rimarrin dokumentacionin e duhur. (gjetje nr. 20)
- **Rishikimi i përshkrimeve të punës ose i mandatit apo rolit që u buron nga ligji për profesionistët e përfshirë në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve,** si mjek, infermiere, mësues, pedagog social apo psikolog në shkollë, nëpunës të shërbimit social në nivel komunal, zyrtar policor, mbrojtësve të viktimave si dhe për të gjithë profesionistët e tjerë, të cilët parashikohen me ligj (gjetje nr.7).
- **Rekomandohet shtrirja e shërbimit pedagogjik-psikologjik dhe social në gjithë shkollat e Kosovës si dhe fuqizimi dhe inkurajimi i nxënësve për t’iu drejtuar psikologut, pedagogut social në shkollë, duke përfshirë këshillimin për karrierën e tyre në të ardhmen,** për trajtimin e çështjeve të fëmijërisë dhe adoleshencës në përgjithësi. Kjo do të ndihmonte në identifikimin e hershëm të rasteve të mundshme të

dhunës, abuzimit dhe neglizhimit, si dhe do të ndihmonte në arritjen e ofrimit të shërbimeve mbrojtëse në kohë. Pedagogu social dhe psikologët e shkollave duhet gjithashtu të bashkëpunojnë me efikasitet me prindërit dhe partnerë të tjerë të rëndësishëm për jetën e fëmijës. (gjetje nr. 8).

4.2.3 Rekomandime lidhur me përmirsimin e koordinimit ndërmjet institucioneve dhe funksionimit të sistemit:

- **Ngritja e një strukture koordinuese për politikën e çështjes së mbrojtjes së fëmijëve në nivel të politikëbërjes.** Duke pasur parasysh situatën aktuale, strukturat ekzistuese të ngritura, rolin dhe mandatin e tyre si dhe duke i dhënë rëndësinë e duhur ushtrimit të vizionit të realizuar me anëtarët e Këshillit Ndërmnistror, mendimeve dhe opinionit të tyre në këtë drejtim si dhe gatishmërisë të disa prej institucioneve të kyçura në këtë çështje rekomandohet ngritja e strukturës si vijon: Këshilli Ndërmnistror për Reformën në Drejtësinë për të Mitur të zgjerohet mandatin e tij në Këshillin për Mbrojtje dhe Drejtësi për Fëmijë. Gjithashtu, sugjerohet që ky Këshill të vendoset pranë Zyrës për Qeverisje të Mirë të Kryeministrit. Rekomandohet që ZQM/ZKM të funksionojë si sekretariat për këtë këshill si dhe të gjitha këshillet tjera të themeluara në fushë e të drejtave të njeriut dhe fëmijëve. Roli i ZQM/ZKM si sekretariat për të gjitha këto këshilla do të forcojë koordinimin e punës dhe veprimeve duke përfshirë ndërmarrjen e iniciativave. Në këtë drejtim rekomandohet që ZQM/ZKM të fuqizohet me resurse humane dhe kapacitete të tjera të nevojshme. Nga ana tjetër, ky sekretariat do të shërbejë si një koordinues dhe do të lehtësojë përcjelljen e mendimeve dhe iniciativave të propozuara nga këshilli, tek Këshilli Ndërmnistror për të Drejtat e Fëmijëve i udhëhequr nga Kryeministri. Në këtë mënyrë ZQM/ZKM parashikohet të shërbejë si një strukturë mbështetëse për të gjitha politikën në fushën e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të fëmijëve, duke luajtur rolin e një aktori kryesor, i cili lehtësisht mund të adresojë në agjendën politike çështje kryesore të mbrojtjes së fëmijëve dhe të lehtësojë aprovimin e dokumenteve strategjike apo akteve të ndryshme normative të sugjeruara nga komitetet e sipërpërmendura, duke përfshirë ato të Këshillit për Mbrojtje dhe Drejtësi për Fëmijë. Nga ana tjetër, duke pasur parasysh se ZQM/ZKM ka shtrirje edhe në nivel lokal nëpërmjet Njësive për të Drejtat e Njeriut, rezulton se skema e rekomanduar duke i dhënë një funksion të zgjeruar ZQM/ZKM mundëson një koordinim veprimesh dhe politikash si në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal. (gjetja nr.7).
- **Sistemi i Mbrojtjes së Fëmijëve duhet të fuqizohet dhe bëhet më efektiv, duke siguruar funksionimin si një sistem integral në nivel qendror dhe në nivel lokal,** për parandalimin, mbrojtjen dhe ri-integrimin e fëmijëve viktimë ose në rrezik për të qene të abuzuar, të dhunuar, të neglizhuar, fëmijëve në konflikt me ligjin, fëmijëve dëshmitarë dhe në përgjithësi të gjithë fëmijëve të grupeve që kërkojnë një mbrojtje të posaçme (p.sh: fëmijëve me nevoja të veçanta, fëmijët e minoriteteve, apo fëmijëve të zhvendosur, dhe në përgjithësi të gjithë fëmijët në nevojë për mbrojtje). Në këtë kuadër është e rëndësishme që bashkëpunimi ndër-institucional në nivel qendror dhe nivel lokal, pra si në aspektin vertikal dhe horizontal, të rregullohet në bazë të marrëveshjeve apo referencave ligjore të qarta në ligj, të cilat lejojnë funksionimin e sistemit të referencës dhe të qasjes multidisiplinare për trajtimin e rasteve. Anëtarët e nën-këshillit kanë përpunuar një skemë të mundshme që mund të ndiqet për të realizuar funksionimin efikas të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në nivelin qendror dhe lokal. (Shih bashkëngjitur skemat në aneksin 2 dhe 3).

Në këtë kuadër është e rëndësishme që të garantohet sidomos koordinimi në nivel lokal, duke inkurajuar përfshirjen e Njësive për të Drejtat e Njeriut në Komuna. Pozita e këtyre njësive është shumë e favorshme pasi ato kanë një varësi relevante nga MAPL, Zyra për Qeverisje të Mirë edhe nga Komuna, dhe në këtë mënyre janë njësitet më të volitshme për të luajtur rolin e koordinatorit kryesor në komunë për mbrojtjen e fëmijëve. Në mënyrë më të detajuar këto njësi do të duhet të ndërmarrin të gjitha veprimet për koordinimin e departamenteve dhe agjencive në nivel komunal të ndërlidhura me çështjet e mbrojtjes së fëmijëve, për garantimin e qasjen multidisiplinare për trajtimin e rasteve. Këto njësi gjithashtu do të duhet të raportojnë, të referojnë apo të ndërhyjnë në nivel qendror nëpërmjet Zyrës për Qeverisje të Mirë për marrjen e veprimeve apo vendimeve të caktuara koordinuese për rastet e mbrojtjes së fëmijëve të cilat janë objekt i institucioneve të qeverisë qendrore apo i institucioneve të pavarura të cilat janë në nivel qendror.

Në këtë kuadër, një praktikë tjetër, e cila gjithashtu mund të merret si model i mirë është modeli Task Force, i cili është ngritur në 6 komuna, bazuar në Projektin “Ngritja e një Sistemi të Mbrojtjes së Fëmijëve”, zbatuar nga Terre des hommes dhe UNICEF dhe që synon forcimin e menaxhimit të rasteve. Këto Task Forca veprojnë në bazë të një marrëveshje mes të Terre des hommes, Drejtoritë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komuna. Po ashtu model i mirë është ai i Grupeve të Veprimit në Komuna: Ngritja e Grupeve të Veprimit në Komuna (GVK) në Prizren dhe Gjilan, i parashikuar në kuadër të Programit në Përgjigje kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe i mbështetur nga Save the Children. Më tej, rekomandohet të bëhet tërë ri-përshkrimi i punës së zyrëtarit për të drejtat e fëmijëve dhe të fuqizohet pozicioni i tij, pasi ky zyrëtar do të marrë rolin e koordinatorit për mbrojtjen e fëmijëve në nivel lokal (gjetja nr. 7).

Bazuar në një studim të fundit të Terre des hommes, “zyrëtarit për të drejtat e fëmijëve në kuadër të Komunave”, rezulton se ka probleme në ushtrimin e detyrës dhe ushtrimin e mandatit dhe përgjegjësi të punës.

- **Rekomandohet përmirësimi i mbledhjes së të dhënave statistikore në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve, duke përshtatur dhe harmonizuar tabelat e mbledhjes së të dhënave me indikatorët global në këtë fushë.** Në këtë kuadër, është e nevojshme ndryshimi i akteve nënligjore, të tilla si rregullore, udhëzime të nxjerra nga ESK mbi të cilat bazohet bashkëpunimi ndërinstytucional për mbledhjen e të dhënave dhe në bazë të të cilave prodhohen këto të dhëna. (gjetje nr.1)
- **Hartimi i formave unike të referimit të dhunës në të gjitha institucionet të cilët për shkak të mandatit apo rolit të tyre vijnë në dijeni të rasteve të fëmijëve të abuzuar, dhunuar apo neglizhuar.** Më konkretisht, forma unike apo standarde për referim duhet të hartohet për mësuesit apo personelin ndihmës në shkollë, për mjekët dhe infermierët, nëpunësit e shërbimit social, punonjësit e policisë, mbrojtësit e viktimave, prokurorët, gjyqtarët dhe avokatët me qëllim identifikimin, referimin dhe më pas trajtimin e rasteve të dhunës (gjetja nr. 8).

4.2.4 Rekomandimet për të adresuar kapacitetet e resurseve njerëzore, analizës së situatës dhe normave shoqërore lidhur me mbrojtjen e fëmijëve:

- **Të ndërmerren studime të posaçme për të evidentuar situatën e fëmijëve në lidhje me fenomenet e lypjes, punës së fëmijëve si në qytet ashtu edhe në fshat, duke përfshirë edhe fëmijët e rrugës si kategori e cenueshme për shfrytëzim ekonomik, trafikimit të fëmijëve, martesat e hershme etj, me qëllim evidentimin e mekanizmeve më efikas për trajtimin e përshtatshëm të kësaj situatë.** Në këtë veprim duhet të përfshihen strukturat lokale dhe OJQ-të. Ndërkohë që rekomandimet duhet të lejojnë edhe përfshirjen e strukturave apo masave fleksibël, në mënyrë që t'i përgjigjen dinamikave të fenomeneve të sipërpërmendura. (gjetja nr. 6, 18, 19)
- **Të ndërmerren fushata të vetëdijesimit lidhur me:**
 - a për komunitetin në lidhje me praktika të dëmshme dhe të drejtat e fëmijëve siç janë martesat e hershme apo shfrytëzimi ekonomik i fëmijëve përfshirë lypjen dhe punën në rrugë, si dhe të gjitha format e rrezikshme të punës së fëmijëve (gjetja nr. 18, 19, 20); dhe
 - b fushata për rritjen e vetëdijesimit kundër dhunës për grupe të ndryshme të synuara si: (i) fëmijët, duke synuar rritjen e vetëdijesimit për përdorimin e mekanizmeve të ankimit dhe të vetë raportimit të dhunës apo të abuzimit por edhe në lidhje me respektimin e rregullave të sjelljes në shkollë; (ii) mësuesit në lidhje me mjetet e lejuara të disiplinës; (iii) prindërit në lidhje me mospërdorimin e dhunës ndaj fëmijëve në përgjithësi; (iv) nëpunësve të shërbimit social, avokatëve, gjyqtarëve, prokurorëve, punonjësve të policisë, etj. (gjetja nr. 8).
- **Është e nevojshme të fuqizohen përpjekjet për ngritjen e një dege në fakultet për punonjës social, çka do të garantonte një cilësi më të lartë në nivelin e burimeve njerëzore të angazhuara në Sistemin e Mbrojtjes së Fëmijëve.** Ngritja e një universiteti/fakulteti do të lejojë që të ketë më shumë profesionistë me formim të posaçëm në ofrimin e shërbimeve sociale, të cilat përbëjnë edhe një nga drejtimit kryesore ku mbështetet sistemi i mbrojtjes së fëmijëve. Gjithashtu duhen marr masa që këta profesionist të kenë preference në vende të caktuara pune në krahasim me profesionet e përcaktuara si legjitime për kryerjen e rolit të nëpunësit të shërbimeve sociale. (gjetja nr.9).
- **Organizimi i programeve të trajnimit, përfshirë përgatitjen e kurrikulave të veçanta për të gjithë profesionistët e përfshirë në sistemin e Mbrojtjes së Fëmijëve, të dedikuara për trajtimin e rasteve të fëmijëve të abuzuar, dhunuar, neglizhuar për të gjithë profesionistët e përfshirë;** si mjekë, infermierë, mësues, punonjës policie, mbrojtësit e viktimeve, avokatë, gjyqtarë, prokurorë. Sugjerohet që moduli i trajnimeve të jetë i koordinuar në mënyrë që të sigurohet që profesionistët të kenë të njëjtën qasje bazuar në të njëjtat parime, interpretime apo shkolla mendimi profesionale për të garantuar një unitet qasje multi-disiplinare të rasteve. Gjithashtu duhet të ekzistojnë brenda ministrive struktura të posaçme për organizimin e një programi të mirëfilltë trajnimi me nivele të ndryshme njohurish të cilat bëhen baze për certifikim me nivele dhe licencim (gjetje nr.14).

Më konkretisht sugjerohet:

1. Të krijohet një program i vazhdueshëm trajnimi nga Oda e Avokatëve për avokatët. Ky program do të mundësonte organizimin e trajnimeve për specializimin e avokatëve në mbrojtjen e fëmijëve në konflikt me ligjin, fëmijëve viklima dhe fëmijëve dëshmitarë. Gjithashtu, avokatët që mbrojnë fëmijët duhet të certifikohen si avokat për fëmijët, specializimi i të cilëve duhet parashikuar me ligj. Ky rekomandim është mbështetur edhe nga “Vlerësimi i Odës së Avokatëve në Kosovë”, UNICEF, korrik 2010.
2. Të krijohen programe trajnimi të posaçme për gjyqtarët dhe prokurorët pranë Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve përfshirë edhe teknikat miqësore të intervistimit të fëmijëve, kryesisht fëmijëve viklima.
3. Qendra Kosovare për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim të ndërmarrë programe të vazhdueshme trajnimi për punonjësit e Shërbimit Sprovues dhe Korrektues të Kosovës dhe kjo duhet të përfshijë tema për të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre.
4. ZQM të kontraktojë ose të organizojë programe trajnimi të vazhdueshme në lidhje me të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve me personelin e Njësive për të Drejtat e Njeriut në nivel qendror dhe lokal.
5. Departamenti për Mbrojtjen e Viktimave të ndërmarrë programe të trajnimit të vazhdueshëm në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve për të gjithë punonjësit/mbrojtës të viktimave.
6. Të organizohen trajnime me pjesëmarrje multidisiplinare aktorësh në një fazë të dytë, pas organizimit të raundit të parë të trajnimeve, siç përmendet më sipër dhe pasi një njohuri bazike adekuate është garantuar për të gjithë aktorët e përfshirë.

5. Sistemi i drejtësisë për fëmijët dhe qështjeve të sigurisë

Nën-këshilli i qështjeve të drejtësisë dhe të sigurisë kishte si qëllim të identifikonte, vlerësonte dhe të evidentonte qështjet kryesore për Drejtësinë për të mitur dhe Sigurinë e tyre, përgjegjësitë e ministrive përkatëse si: Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme.

Për të arritur këtë objektiv, nën-këshilli ishte përgjegjës për plotësimin me informacion të instrumenteve të mëposhtë me:

Instrumenti 1c:	Konteksti global
Instrumenti 2b (i):	Hartëzimi i ministrisë kryesore
Instrumenti 2c (i):	Fëmijët dhe Drejtësia
Instrumenti 2c(ii):	Procesi i Drejtësisë
Pjese nga Instrumenti 1b:	Informacion bazë dhe profili i rrezikut të vendit
Pjese nga Instrument 1d:	Konteksti ligjor dhe politik.

Mbledhja e informacionit u krye nëpërmjet organizimit të dy punëtorive me pjesëmarrjen e anëtarëve të nën-këshillit, me qëllim që:

- Të jepej një vlerësim i shkallës të zbatimit nga vendi dhe konteksti rajonal dhe global i të drejtave të fëmijëve;
- Hartëzimi i Ministrisë së Drejtësisë, e cila ka një përfshirje dhe përgjegjësi të madhe në mbrojtjen e fëmijëve;
- Të përshkruhet roli dhe përgjegjësitë e çdo ministrie kryesore, gjykatave ose agjencive të tjera në çdo fazë të procesit të drejtësisë (nga arresti tek pas lirimimi) dhe për çdo kategori të fëmijëve (fëmijë në konflikt me ligjin, viktimë, dëshmitarë, ose fëmijë në nevojë për përkujdesje dhe mbrojtje, p.sh. nga abuzimi); dhe
- Të vlerësojë pikat e forta dhe të dobëta të procesit të drejtësisë.

5.1 Gjetjet kryesore

1. **Legjislacioni për fëmijët është i copëzuar dhe i shpërndarë.** Ka ligje dhe strategji të ndryshme që lidhen me të drejtat e fëmijëve. Mbetet prioritet nevoja për draftimin e legjislacionit që mungon, dhe miratimi i projektligjeve apo strategjive të përgatitura, p.sh. projektligji “Për mbrojtjen e dëshmitarëve.” Gjithashtu, pritet të nënshkruhet dhe të miratohet nga Kryeministri brenda 2011 dhe Strategjia e «Sigurisë në Bashkësi» dhe më pas do të hartohet dhe miratohet Strategjia e Policimit në Komunitet. Pritet gjithashtu të miratohet Plani i Veprimit dhe Strategjia Nacionale 2011-2014 kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Në këtë Plan Veprimi është një aneks i veçantë për mbrojtjen e fëmijëve. Po ashtu, pritet të miratohet “Programi për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje”, si një detyrim që buron nga “Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje”.
2. **Ndryshimi i kuadrit ligjor dhe institucional për fëmijët dëshmitarë.** Aktualisht pothuajse nuk është bërë asgjë në këtë drejtim. Mendohet se projektligji i ri, që pritet të miratohet për “Mbrojtjen e Dëshmitarëve”, do të bëjë një rregullim normativ të këtij problemi.
3. **Amandamenti i dispozitave në lidhje me paraburgimin e të miturve,** bazuar në dispozitat aktuale ligjore dhe dispozitat në lidhje me paraburgimin, qëndrimi i të miturve në ambientet e paraburgimit bëhet për një kohë të gjatë. Në këtë kuadër, duhet të ndryshohen dispozitat në lidhje me paraburgimin e të miturit me qëllim uljen e kohës së qëndrimit, në përputhje edhe me standardet ndërkombëtare.
4. **Amandamenti i ligjit “Për Prokurimi Publik” Nr. 3/L-241, datë 30.09.2010,** ky ligj parashikon kontraktimin e shërbimeve për fëmijët jashtë strukturave të Ministrisë së Drejtësisë si p.sh: shërbimet shëndetësore për viktimat e trafikimit që strehohen në Shtëpinë e Përkohshme të Sigurt si dhe shërbime të tjera, të cilat nuk mund të mbulohen nga Ministria e Drejtësisë për efekt kapacitetesh. Megjithatë fusha e kontraktimeve mund të shtohet për të përfshirë një gamë më të gjërë shërbimesh. Procedurat e prokurimit duhet të thjeshtëzohen që të jenë më efikase dhe të garantojnë zbatimin e ligjit në lidhje me dëmshpërblimin e viktimave.
5. **Ngritja e kapaciteteve të personelit, i cili merret me prokurimin e shërbimeve dhe kryerja e certifikimit të tyre në fushën e prokurimit.** Nga vlerësimi rezulton se vetëm një numër i vogël i zyrtareve të prokurimit në institucionet qeverisëse ka njohuritë e duhura për mënyrën e realizimit dhe zbatimit të ligjit. Auditori i përgjithshëm ka rekomanduar forcimin e monitorimit dhe përcjelljen e aktivitetit të prokurimit.
6. **Mungesa e fondeve të mjaftueshme në ofrimin e shërbimeve.** Shërbimi Sprovues ka nevojë për kontraktimin e shërbimeve, por deri tani ato kanë munguar. Procedurat e prokurimit të shërbimeve janë të vështira. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik monitoron prokurimet, dhe Organi Shqyrtues i Prokurimit trajton ankesat në lidhje me prokurimet. Divizioni për Mbrojtjen e Viktimave ka nevojë për më shumë shërbime për mbrojtjen e viktimave, veçanërisht për viktimat e dhunës në familje, keqtrajtimit dhe abuzimet e fëmijëve dhe keqpërdorimet seksuale të cilat për momentin nuk marrin shërbim nga Ministria e Drejtësisë. Shërbimi Sprovues ka nevojë të ofrojë shërbime të cilat nuk janë të buxhetuara në buxhetin e Shërbimit Sprovues. Nuk ka fonde për dëmshpërblimin e viktimave dhe nuk ka fond emergjent për shërbime.

- 7. Ekziston një shpërndarje e mirë e strukturave relevante të MD-së që punojnë me kategori të ndryshme fëmijësh në të gjithë vendin, si në nivel kombëtar poashtu edhe në atë lokal** - Në këtë kuadër evidentohet se funksionon Shërbimi Sprovues, Shërbimi Korrektues, Departamenti për Qasje në Drejtësi, Departamenti për Çështje Ligjore, Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave, Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar, Departamenti i Mjekësisë Ligjore. Njësia për të Drejtat e Njeriut ka të përcaktuar në strukturë zyrtarin e saj për të drejtat e fëmijëve me udhëzim administrativ, i cili duhet të emërohet pasi pozicioni është vakant momentalisht. Në kuadër të Departamentit për Qasje në Drejtësi ekziston edhe Shtëpia e Përkohshme e Sigurt, e cila strehon viktimat fëmijë të trafikimit. Po ashtu, edhe Policia mbulon gjithë vendin me strukturat e saj.
- 8. Organizimi gjyqësor funksionon pjesërisht me ligjin e vjetër dhe pjesërisht me ligjin e ri “mbi gjykatat”**: Ligji i ri mbi gjykatat pjesërisht ka hyrë në fuqi në janar 2011 dhe përfundimisht do të zbatohet në 2013.
- 9. Nuk ekzistojnë gjykata të posaçme për të mitur megjithatë ka gjyqtarë për të mitur në disa gjykata**- Ligji i ri për gjykatat parashikon krijimin e departamenteve të veçanta për të mitur pranë gjykatave themelore dhe të Apelit. Në rang vendi aktualisht janë gjithsej 246 gjyqtarë, disa nga këta merren edhe me raste për të mitur në konkretisht në 7 (shtatë) Departamenti për Qasje në Drejtësi, Departamenti për Çështje Ligjore, Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave, Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar, Departamenti i Mjekësisë Ligjore, Gjykata Komunale dhe në 5 (pesë) Gjykata të Qarkut, si dhe 1 (një) gjyqtar në Gjykatën Supreme. Nuk ka kritere të veçanta për të përzgjedhur gjyqtarët për fëmijë, ata caktohen nga kryetari i gjykatës. Për shkak të mungesës së numrit të mjaftueshëm të gjyqëtarëve, gjyqtari për të mitur mund të merret dhe me çështje për të mitur, por edhe për persona madhor.
- 10. Nuk ka zyra të veçanta për të miturit brenda Prokurorisë**. Në Kosovë ka gjithsej 88 prokurorë nga të cilët në nivel komunal janë vetëm 7, të cilët janë për të mitur, ndërkohë që nuk ka prokurorë për të miturit në nivel qarku.
- 11. Gjyqtarët dhe prokurorët nuk preferojnë të merren me çështjet gjyqësore që lidhen me fëmijët**, sepse i shohin me indiferencë këto çështje dhe mendojnë se ato nuk përbëjnë një fushë për zhvillim profesional.
- 12. Në mjaft gjykata kushtet e punës dhe infrastruktura për gjyqtarët janë të papërshtatshme dhe ata kanë një ngarkesë të madhe me raste**, çka i kufizon atyre mundësinë për të vepruar drejt dhe në kohë për rastet e të miturve. Gjithashtu, edhe sipas një studimi të OSBE-së, Shkurt 2011, “Gjykimi i rasteve familjare në Kosovë: Çështjet lidhur me menaxhimin e lëndëve” rezulton se janë evidentuar vonesa të mëdha në zgjidhjen e rasteve për shkak të ngarkesës së madhe. Kjo ngarkesë vjen kryesisht për shkak të numrit të pamjaftueshëm të gjyqëtarëve dhe prokurorëve për të mitur.
- 13. Nuk ekzistojnë avokatë të specializuar për të miturit**
Shërbimet e ofruara nga Oda e Avokatëve dhe Ndihma juridike kanë qenë jo efektive për të miturit. Mbetet problematike çështja e avokatit të fëmijëve në konflikt me ligjin, pasi për këtë kategori profesionistësh, nuk ka as trajnime specifike për të drejtat e fëmijëve, dhe as për aftësimin e tyre për kryerjen e një mbrojtjeje adekuate për fëmijët. Gjithashtu, për ta nuk ekzistojnë protokolle, manuale apo udhëzues, të cilët tregojnë se si duhet vepruar

avokati në rastet e të miturve në përgjithësi dhe në rastet kur ai është caktuar “ex-officio”. Të miturit e intervistuar që janë në konflikt me ligjin tregojnë se janë takuar me avokatin vetëm në seancë gjyqësore dhe ata janë pyetur pa praninë e avokatit në veprimet para e pas ndalimit. Në këtë procedurë pyetjesh, nuk kanë qenë prezent as prindërit dhe as psikologu apo ndonjë punonjës social. Gjithashtu, mbrojtja e tyre nga avokati nuk është bazuar në ndonjë strategji apo përgatitje të mëparshme dhe takimi me avokatin realizohet vetëm në seancat gjyqësore.

Oda të ndërmarrë veprime lobuese për kërkimin e fondeve nga Këshilli Gjyqësor duke krijuar dhe fuqizuar skemën e administrimit të caktimit të avokatit ex-officio në raste kur mbrojtja është e detyrueshme, skeme e cila ka si përfitues kryesor të miturit në konflikt me ligjin dhe viktimat.

14. **Rezultoni se respektohet ndarja e të miturve nga të rriturit gjatë qëndrimit në Shërbimin Korrektues-Qendra Edukuese Korrektuese e Lipjanit-Stafi** i Shërbimit Korrektues realizon ndarjen e të miturve nga të rriturit duke pasur parasysh fazat e procesit gjyqësor dhe duke i ndarë të miturit në kategori të ndryshme si të: (paraburgosur, të dënuar dhe me masa edukative). Shërbimi Korrektues ka staf të përkushtuar dhe profesional që shërben vetëm për të miturit.
15. **Shërbimi Sprovues i ekzekuton masat dhe dënimet alternative për të mitur, bën anketat sociale për të mitur, si edhe raportin para ndëshkues.** Shërbimi Sprovues, kryen funksionin e përkujdesjes pas lirit të të miturit, ofron shërbime dhe mbikëqyr në bashkëpunim me Shërbimin Korrektues dhe komunitetin programin e Përkujdesjes pas Lirit. Megjithatë, është e nevojshme të realizohet specializimi i stafit nga agjencitë brenda Ministrisë së Drejtësisë në lidhje me çështjet e fëmijëve në konflikt me ligjin.
16. **Në Shërbimin Sprovues dhe Divizionin për Mbrojtjen e Viktimave nuk ka personel të dedikuar vetëm për të miturit,** dhe personeli në përgjithësi, bazuar në përshkrimet e punës, ka përgjegjësi si për të miturit edhe personat madhor.
17. **Administrata shtetërore është objekt i lëvizjeve dhe largimit të vazhdueshëm të personelit që merret me fëmijët.** Arsyeja kryesore e largimit të personelit evidentohet të jenë pagat e ulëta dhe kushtet e tjera të punës shumë të favorshme në disa agjenci të tjera. Kjo vlen kryesisht për Shërbimin Sprovues, Shërbimin Korrektues, si dhe mbrojtësit e viktimave. Lëvizja e vazhdueshme e stafit vihet re edhe brenda policisë nga një sektor tek një tjetër.
18. **Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Kosovës kanë nxjerrur udhëzime administrative që lidhen me fëmijët në konflikt me ligjin të bazuara në Ligjin për Policinë si dhe procedurat standarde operuese lidhur me qasjen ndaj fëmijëve dhe të miturit bazuar në Ligjin për Policinë e Kosovës.** Policia e Kosovës gjithashtu organizon edhe fushata senzibilizuese përmes njësisë së Policisë në komunitet për ngritjen e vetëdijësisë tek fëmijët. Për më tepër Policia e Kosovës ka zbatuar edhe projekte lidhur me çështjen e komunikacionit dhe kundërpërdorimit të alkoholit dhe lypjes.
19. **Evidentohet bashkëpunim i mirë i Policisë me Qendrën për Punë Sociale në nivel lokal, me gjykatat, me prokurorët, drejtoritë e arsimit, OJQ-të dhe mediat brenda sistemit të mbrojtjes së fëmijëve.** Por gjithsesi, rezultoni të ketë mungesa të mjeteve financiare për realizimin e aktiviteteve/ programeve, trajnimeve të avancuara të punonjësve të policisë që merren me hetimin e çështjeve për të mitur. Sidoqoftë, evidentohet

mungesa e burimeve financiare për të realizuar aktivitetet dhe programet e nevojshme. Gjithashtu ka mungesë të mjeteve të nevojshme për të realizuar aktivitetet dhe programet për avancimin e trajnimeve për Policinë e Kosovës që mirren me hetimin e të miturve delikuentë, dhe mungesa e njësive të specializuara për tu marrur ekskluzivisht me fëmijët viktima. Gjithashtu edhe studimi i OSBE-së “Gjykimi i rasteve familjare në Kosovë: Çështjet lidhur me menaxhimin e lëndëve”, shkurt 2011 evidenton mbikëqyrje jo-adekuate gjyqësore të rolit të Qendrave për Punë Sociale në rastet gjyqësore. Për më tepër sipas studimit të OSBE-së, Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Komuniteteve-Seksionit për Monitorimin e Sistemit Juridik, të titulluar “Mbrojta ligjore jo efektive”, shtator 2010, vihen në dukje problematikat e përmendura me sipër.

20. **Rezultoni të funksionojë një një sistem për identifikimin dhe referimin e fëmijëve viktima nga ana e Policisë së Kosovës.** Sistemi mundëson që Policia të ofrojë mbështetje të menjëhershme për fëmijët viktima dhe që ata ti referoj në Qendra për Punë Sociale dhe te Mbrojtësi i viktimave. Në nivel qendror koordinimi arrihet në kuadër të drejtorive përkatëse, në përbërje të të cilave janë njësitë për parandalimin e delinkuencës së të miturve, njësia kundër trafikimit të qenieve njerëzore, të substancave narkotike dhe të dhunës në familje. Të gjitha këto njësi kanë brenda tyre sektorë të specializuar për të mitur.
21. **Veprimet parandaluese dhe hetimore të policisë për fëmijët ndiqen veçmas nga policia në nivel lokal** - në rajon dhe stacion policor ekzistojnë njësitë përkatëse hetimore të policisë për hetimin e fëmijëve në konflikt me ligjin.
22. **Evidentohet mungesa e trajnimeve të avancuara të zyrtarëve policorë** të cilët merren me hetimin e delikuencës së të miturve si dhe mungesa e njësive të specializuara, të cilat duhet të merren posaçërisht me fëmijët kryes dhe viktima.
23. **Në shtatë stacione policore janë krijuar dhoma miqësore të intervistimit për fëmijët,** me synim shtrirjen e tyre në të gjitha stacionet policore të Kosovës. Megjithatë iniciativa është shumë e mirë, aktualisht mungojnë fondet për ta shtrirë këtë projekt të dhomave miqësore në të gjitha stacionet policore. Gjithashtu, evidentohet mungesa e hapësirave adekuate për fëmijët e ndaluar në stacionet policore.
24. **Bashkëpunimi dhe koordinimi institucional.** Ekziston bashkëpunimi i avancuar brenda agjencive të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si dhe ndarja e detyrave dhe përgjegjësisë. Ekziston praktika se nuk mund të intervistohet fëmija pa praninë e përfaqësuesit të Organit të Kujdestarisë, megjithatë është evidentuar mungesa e punonjësve socialë, të cilët pas procesit të decentralizimit tani janë në varësi të komunave. Gjithashtu evidentohet mungesa e protokolleve referuese, si dhe është evidentuar mungesa në dhënien e informacionit kthyes në lidhje me procedimet e mëtejshme të rasteve. Kjo gjë ndikon negativisht në bashkëpunimin institucional. Mungesa e bazës së të dhënave të integruara mes gjithë agjencive të zbatimit të ligjit është një arsye tjetër për mungesën e veprimeve të koordinuara gjatë gjithë kohës së trajtimit të rasteve në sistem. Ekziston një model i mirë i bazës së të dhënave të integruar për trafikimin me qenie njerëzore ku përfshihen edhe të dhënat për trafikimin e fëmijëve në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
25. **Bashkëpunimi dhe koordinimi institucional ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të tjera duhet të forcohet.** Pavarësisht nga hapat pozitivë në fushën e bashkëpunimit, duhet të forcohet më tej bashkëpunimi ndërmjet ministrive dhe agjen-

cive tjera. Përkunder disa Memorandumeve të Mirëkuptimit të nënshkruara, ky bashkëpunim nuk ka qenë gjithmonë i mirë, pasi që memorandumet e njëjta nuk janë zbatuar si duhet. Në lidhje me këtë bashkëpunim ka ndikuar edhe legjislacioni, i cili nuk e ka pasur qartësinë e duhur. Megjithatë, krijimi i Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave pranë Ministrisë së Drejtësisë me funksion koordinimin e procesit të integritit evropian, procesin e planifikimit strategjik dhe zhvillimin e politikave, si edhe koordinimin e asistencës së huaj në Kosovë, mund të ndihmojë në përmirësimin e situatës në këtë drejtim.

26. **Mungesa e koordinimit qendror të donatorëve** - Ndonëse asistenca e huaj dhe donatorët nuk kanë munguar, theksojmë se mos koordinimi qendror i donatoreve ka paraqitur gjithmonë problem për Ministrinë e Drejtësisë dhe Qeverinë. Sidoqoftë, Qeveria është në proces të krijimit të mekanizmave për të përmirësuar koordinimin me donatorë.
27. **Evidentohen vështirësi të aksioneve riintegruese për të miturit pas lirit nga qendra edukuese/korrektuese e Lipjanit.** Asistimi i të miturve pas lirit (ndihma post-penale), është shumë e rëndësishme për realizimin e riintegrit të tyre në shoqëri. Duhet të mundësohen nga strukturat përkatëse shtetërore programe apo shërbime me qëllim futjen e tyre në skemat e punësimit dhe lehtësimi i krijimit të marrëdhënieve të punës. Evidentohet se institucionet e paraburgimit dhe burgimit nuk kanë këto mundësi financiare për të ofruar të miturit shërbimet e mësipërme. Situata e të miturve, të sipërpërmendur, vështirësohet edhe më shumë po të konsiderojmë se mundësitë e tregut të punës në Kosovë nuk janë të favorshme, dhe për të miturit është e shumë e vështirë të gjejnë punë edhe pse ata kanë marrë një formim profesional gjatë qëndrimit në institucion.
28. **Bashkëpunim i kufizuar mes gjithë aktorëve të drejtësisë për të mitur.** Evidentohet një bashkëpunim i limituar mes Shërbimit Korrektues dhe Shërbimit Sprovues, gjykatësve, prokurorëve, dhe avokatëve.
29. **Monitorimi i respektimit të të drejtave të fëmijëve në konflikt me ligjin në institucione** Në Kosovë ekzistojnë disa agjenci si: Qendra për Rehabilitim e të Mbijetuarve nga Tortura në Kosovë, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, OJQ, Institucioni i Avokatit të Popullit, të cilët i vizitojnë të miturit lidhur me kushtet e trajtimit dhe respektimin e të drejtave të tyre të garantuara me ligj. Në këtë aspekt është e nevojshme të fuqizohet roli i Njësive për të Drejtat e Njeriut, si pjesë e Zyrës për Qeverisje të Mirë.
30. **Trajnimet për gjyqtarët dhe prokurorët**- Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim dhe koordinim me Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës, ka përgjegjësi ligjore për trajnimin e gjyqtarëve dhe, prokurorëve në detyrë, përgatitjen profesionale të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë, gjyqtarëve porot, si dhe trajnimin e profesionistëve të tjerë në kuadër të sistemit gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës, të identifikuar nga ky Institut. Instituti Gjyqësor i Kosovës ka qenë efikase në zhvillimin e programeve dhe organizimin e trajnimeve në kuadër të Programit të Vazhdueshëm për Arsimimin Ligjor (PVAL) për gjyqtarët dhe prokurorët, trajnimeve nga Programi Trajnues për Avancim (PTA) dhe trajnimeve në Programin Fillestarë për Arsimimin Ligjor (PFAL). Instituti Gjyqësor i Kosovës organizon rregullisht trajnime për trajnuesit e Instituti Gjyqësor të Kosovës në të gjitha fushat duke përfshirë edhe fushën e Drejtësisë për të Mitur. Instituti Gjyqësor i Kosovës për Programin Fillestarë për Arsimimin Ligjor ka hartuar modulën në fushën e Drejtësisë për të Mitur. Instituti Gjyqësor i Kosovës në kuadër të Programit të Vazhdueshëm për Arsimimin Ligjor ka mbajtur trajnime regjionale lidhur me risitë në

Kodin e Drejtësisë për të Mitur dhe një Konferencë përmbyllëse. Instituti në vazhdimësi i rifreskon programet dhe kurrikulat trajnuese në pajtim me nevojat dhe risitë në legjislacion. Trajnimet në Programin e Vazhdueshëm për Arsimimin Ligjor nuk janë ende të karakterit obligues (nga janari i 2013 do të jenë të karakterit obligues). Në këtë kuadër, është i nevojshëm hartimi i programeve dhe kurrikulave të përshtatshme si dhe garantimi i fondeve të nevojshme për kryerjen e tyre. Po kështu, është e nevojshme që trajnimet të kryhen mbi bazë publikimesh dhe materialesh të shkruara adekuate për këtë qëllim.

31. **Kapacitetet e specializuara për ofrimin e trajnimeve të përmendura më sipër** Në praktikë rezulton se për realizimin e trajnimeve angazhohen kryesisht gjyqtarë me eksperience të gjatë dhe në trajnime ftohen edhe punonjës nga Shërbimi Sprovues, Qendrat për Punë Sociale, Policia e Kosovës, Stafin Korrektues dhe Departamenti për Qasje në Drejtësi, për të forcuar bashkëpunimin dhe koordinimin e aktorëve të drejtësisë për të mitur. Gjithashtu është evidentuar një bashkëpunim shumë i mirë me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë në ofrimin e mbështetjes materiale dhe teknike për ofrimin e këtyre trajnimeve si p.sh. UNICEF në kuadër të projektit të mbështetur nga Zyra e Bashkimit Evropian “Mbështetje Reformave për Sistemin e Drejtësisë për të Mitur në Kosovë-Faza e II”. Trajnimet shërbejnë edhe si forume për zgjidhje të çështjeve që janë shumë të rëndësishme, sidomos duke pasur parasysh mungesën e komentarëve apo materialeve burimore, teorike dhe praktike. Po ashtu evidentohet ngritja e SOS linjës e cila është ngritur pranë Ministrisë Drejtësisë me qëllim që të raportohen rastet e krimit si pjesë e vetëdijesimit të komunitetit.
32. **Evidentohet se institucione apo agjenci të ndryshme kanë të dhënat e tyre në lidhje me kompetencat që kanë për trajtimin e kategorive të ndryshme të fëmijëve në konflikt me ligjin, viktimat apo dëshmitarë.** Në praktikë rezulton se këto të dhëna janë të ndara në varësi të institucioneve qeveritare që i mbledhin dhe që i analizojnë. Të dhënat nuk janë të integruara dhe po ashtu indikatorët e vlerësimit të të dhënave variojnë në agjenci të ndryshme. Si praktikë e mirë ekzistuese përmendet modeli i përmendur më sipër i databazës për trafikim.
33. **Nuk ekziston një mekanizëm që monitoron punën e institucioneve të sistemit të drejtësisë për fëmijë,** dhe nuk ka deri më tani një iniciativë, e cila të verifikonte shkallën e zbatimit të parimeve të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve brenda këtij sistemi, veçanërisht për vendimmarrjen gjyqësore (si p.sh zbatimi i Interesit më të Lartë të Fëmijës etj).

5.2 Rekomandime

5.2.1 Amandamenti dhe plotësimi i strategjive ekzistuese dhe legjislacionit, përfshirë hartimin e ligjeve të reja dhe akteve nënligjore përkatëse:

- **Rekomandohet unifikimi i legjislacionit nga fusha e mbrojtjes së fëmijëve,** nëpërmjet nxjerrjes së ligjit për mbrojtjen e fëmijëve apo kodifikimit të legjislacionit për mbrojtjen e fëmijëve.
- **Rekomandohet të plotësohet dhe amandamentohet legjislacioni si dhe të përgatiten aktet nënligjore për realizimin e zbatimit të ligjit si dhe të hartohen dhe miratohen projektligjet apo strategjitë e përgatitura** si “Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarit”, “Ligji për Prokurimin Publik”, dhe “Strategjia e Sigurisë në Bashkësi” (gjetjet nr.1, 2 dhe 4).
- **Amandamenti i legjislacionit penal në lidhje me shkurtimin e kohës së paraburgimit të të miturit** Në lidhje me paraburgimin e të miturve, dispozitat aktuale bëjnë që të miturit të qëndrojnë për kohë të gjatë në paraburgim, që është një shkelje e standateve ndërkombëtare. Në këtë aspekt, duhen ndryshuar dispozitat relevante të Kodit të Drejtësisë për të Mitur për paraburgimin e të miturit në përputhje me standardet ndërkombëtare. (gjetja nr.3).
- **Rekomandohet të ndryshohet kuadri ligjor dhe institucional për fëmijët dëshmitarë** – Duke pasur parasysh se projekt-ligji për “Mbrojtjen e dëshmitarëve”, i cili pritet të miratohet dhe do të bëjë një rregullim normativ të këtij problemi, është e rëndësishme që të gjithë aktorët e interesuar të kenë mundësi të japin një kontribut për rregullimin e mirëfilltë ligjor të kësaj kategorie fëmijësh, në mënyrë që të mundësohet mbrojtja e tyre gjatë përfshirjes në procesin gjyqësor. (gjetja nr.2)
- **Rekomandohet të përmirësohet infrastruktura ligjore dhe institucionale për kontraktimin e shërbimeve për fëmijët jashtë sistemit të drejtësisë si dhe rritja e fondeve për shërbime.** (gjetjet nr.4 dhe 6).

5.2.2 Çështje në lidhje me zbatimin e ligjit

- **Krijimi i departamenteve për të mitur pranë gjykatave themelore dhe të apelit si dhe i seksioneve për të mitur pranë prokurorive** Inkurajohet dhe mbështetet ideja për krijimin e departamenteve për të mitur pranë gjykatave themelore dhe të apelit, e cila mundësohet me hyrjen e plotë në fuqi të “Ligjit të ri për Gjykatat”, në vitin 2013. Po kështu, është i rëndësishëm krijimi i seksioneve për të mitur pranë Prokurorive. Në një fazë afat-shkurtër është e rëndësishme të bëhet emërimi i gjyqtarëve që merren me lëndë për të mitur dhe të plotësohen vendet vakante të gjyqtarëve dhe prokurorëve profesional për të mitur. Në këtë kuadër një rekomandim i rëndësishëm që rezulton nga studimi i OSBE-së, shkurt 2011, Gjykimi i rasteve familjare në Kosovë: Çështjet lidhur me menaxhimin e lëndëve është që Këshilli Gjyqësor i Kosovës të vazhdojë të trajtojë si gjyqtarët aktual ashtu edhe kandidatët për gjyqtarë. (gjetja nr. 8, 9, 10)

- **Rekomandohet aplikimi sa më i gjerë i alternativave të dënimit, masave të diversitetit dhe masave edukative nga gjykatat dhe prokuroritë** Duke pasur parasysh ndikimin pozitiv që ka shqiptimi i këtyre llojeve të masave për të rinjtë në konflikt me ligjin, atje ku ligji e lejon gjykatat duhet të prirën të shqiptojnë masa alternative për këtë kategori fëmijësh. (gjetje nr. 9)
- **Rekomandohet rritja dhe përmirësimi i hapësirave adekuate për intervistimin e fëmijët në stacionet policore, bazuar në eksperiencën e projektit pilot të zbatuar në këtë kuadër.** (gjetjet nr. 23, 20 dhe 21)
- **Rekomandohet të ndërmerret një iniciativë për monitorimin e punës së aktorëve të sistemit të drejtësisë për fëmijë, veçanërisht e fokusuar në vendimmarrjen gjyqësore.** Disa nga këto standarte përfshijnë: Interesi më i mirë i fëmijeve, marrja në konsideratë e mendimeve dhe pikëpamjeve të fëmijeve, dhe fakti nëse fëmiju është shkelës, viktimë apo dëshmitarë. (gjetje nr. 32)

5.2.3 Çështje në lidhje me koordinimin midis institucioneve dhe funksionimin e sistemit

- **Rekomandohet rritja e fondeve buxhetore në ofrimin e shërbimeve për fëmijët brenda sistemit të drejtësisë. Rekomandohet posaçërisht të krijohet fondi për dëmshpërblimin e viktimave dhe fondi emergjent për shërbim për viktimat e krimit,** dhe fondit për mbështetjen e të miturve në programin për risocializimin dhe riintegrimin e tyre. (gjetje nr.6).
- **Duhet të forcohet bashkëpunimi dhe koordinimi mes të institucioneve.** Pavarësisht nga hapat pozitiv në fushën e bashkëpunimit, duhet forcuar bashkëpunimi mes ministrive dhe agjencive të tjera brenda apo jashtë sistemit formal të drejtësisë si dhe me shoqërinë civile. Në përgjithësi rekomandohet që aty ku ky bashkëpunim nuk funksionon të bëhet vlerësimi përkatës dhe të merren masat adekuate për përmirësimin e tij. Ndërsa aty ku bashkëpunim është pozitiv, duhet përgjithësuar dhe konsoliduar si një praktikë e mirë. (gjetje nr.19, 24, 25).
- **Rekomandohet një bashkëpunim më i mirë mes aktoreve të përfshirë në sistemin e drejtësisë për të mitur** në këtë kuadër përmendim bashkëpunimin mes Shërbimit Korrektues dhe Shërbimit Sprovues, gjykatës, prokurorisë, avokatëve, punonjësve social dhe Departamentit për Qasje në Drejtësi. (gjetja nr. 28)
- **Rekomandohet krijimi dhe mundësimi i ngritjes së bazës të dhënave të integruara mes gjithë agjencive të zbatimit të ligjit** evidentohet në përgjithësi që të dhënat janë të fragmentarizuara dhe çdo institucion prodhon statistikën e tij, si dhe indikatorët që përdoren janë të ndryshëm. Si praktikë e mirë ekzistuese përmendet dhe duhet të merret parasysh modeli i më sipërm i bazës së të dhënave për rastet e trafikimit. (gjetja nr. 24)

- **Rekomandohet përmirësimi i koordinimit qendror i donatorëve në nivel ministror por edhe me Qeverinë.**
(gjetja nr. 26)
- **Rekomandohet të ndërmerren më shumë masa dhe veprime nga institucionet përkatëse në lidhje me ri-integrimin e të miturve pas lirit (ndihma post-penale) si dhe për viktimat e trafikimit pas daljes nga Shtëpia e Përkohshme e Sigurt-** kjo mund të realizohet duke asistuar fëmijët me shërbimet e duhura pas lirit apo në hulumtimin e mundësive për t'ju gjetur punë pas lirit. Po ashtu kjo aplikohet edhe si pjesë e asistencës që duhet t'i jepet viktimave të trafikimit pas daljes nga Shtëpia e Përkohshme e Sigurt. (gjetje nr. 27).
- **Duhet të forcohet roli i mekanizmave që monitorojnë të miturit dhe kushtet e trajtimit të fëmijëve** nga institucionet relevante, si mekanizma që luajnë një rol të rëndësishëm në monitorimin e institucioneve që merren me fëmijët dhe drejtësinë. Në këtë kuadër rekomandohet të fuqizohet roli i Njësisë për të Drejtat e Njeriut dhe Zyrës për Qeverisje të Mirë. (gjetje nr. 29).

5.2.4 Çështje në lidhje me ngritjen e kapaciteteve (trajnimeve), analizim të situatës dhe aktivitete vetëdijesuese

- **Plotësimi i vendeve të zbrazëta në kuadër të Policisë së Kosovës me staf të kualifikuar që merren me çështjet e të miturve.** Rritja e numrit të stafit të kualifikuar në strukturat e policisë do të krijojë mundësinë për respektimin e të drejtave të fëmijëve në këto institucione, në pajtim me standardet ligjore të Kosovës dhe standardeve ndërkombëtare. (gjetje nr.17, 18 dhe 22).
- **Sugjerohet përmirësimi i kushteve të punës për gjyqtarët dhe prokurorët dhe infrastrukturës gjyqësore në përgjithësi për të qenë në përputhje me standardet e të drejtave të fëmijëve**
(gjetje nr. 11 dhe 12).
- **Rekomandohet profilizimi i avokatëve për të mitur, specializimi dhe certifikimi i tyre nga Oda e Avokateve.** Po kështu, duhet të përmirësohet cilësia dhe qasja në shërbimet ligjore të ofruara nga Oda e Avokatëve dhe nga Komisioni për Ndihmë Juridike për të miturit. Cilësia e mbrojtjes dhe ndihmës ligjore falas mbetet shqetësim, i cili u theksua nga pothuajse të gjithë aktorët e përfshirë në drejtësinë për të mitur dhe në sistemin e ndihmës ligjore falas sipas studimit “Vlerësimi i Kapaciteteve të Odës së Avokatëve për përmbushjen e së drejtës së fëmijëve për mbrojtje ligjore - raporti i UNICEF-it, qershor 2010”. E njëjta është vërtetuar edhe në studimin e OSBE-së, Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitetet – Monitorimi i Sistemit Ligjor – “Mbrojtja ligjore jo-efektive”, shtator 2010 rezulton se duhet të rriten trajnimet për avokatët që merren me çështjet e drejtësisë për të mitur (gjetje nr. 13).
- **Rekomandohet rritja e numrit të punonjësve social në QPS në nivel komune që ndjekin çështjet për të miturit në konflikt me ligjin.** Në këtë kuadër, ndarja dhe profilizimi i stafit duhet të shihet si prioritet edhe për Shërbimin Sprovues dhe për Departamentin për Qasje në Drejtësi, kryesisht në nivel lokal. (gjetje nr. 7, 15, 16, 24).

- **Rekomandohet trajnimi i vazhdueshëm i stafit në të gjitha strukturat e sistemit të drejtësisë dhe policisë, për shkak të largimit të vazhdueshëm të stafit të specializuar dhe nevojës për të plotësuar pozitat e mbetura.** Stafi që merret me fëmijët në të gjitha strukturat e sistemit të drejtësisë dhe policisë është subjekt i transferimit apo i largimit për shkak të pagesave apo për shkaqe të tjera profesionale. Në këtë kuadër është e rëndësishme të përmirësohen kushtet e punës dhe motivimet e stafit për të qëndruar. (gjetje nr. 15 dhe 17).
- **Hartimi i Programeve të trajnimit të dedikuar vetëm çështjeve të drejtësisë për fëmijët,** bazuar në manuale dhe protokolle standarde, që duhet të hartohen në baza udhërrëfyese për trajtimin e të miturve nga punonjësit e: policisë dhe zyrtarët e Shërbimit Sprovues, Shërbimit Korrektues, Punëtorët Social dhe Mbrojtësit e Viktimave, etj. Po kështu, duhet rritur numri i trajnerëve me përvojë për të trajnuar stafin relevant që punon në sistemin e drejtësisë për fëmijët. Në këtë kuadër, rekomandohet alokimi i fondeve të mjaftueshme për dhënien e granteve për zhvillimin e programeve të trajnimit. (gjetje nr.31) .
- **Rekomandohet organizimi i fushatave vetëdijësuese për fëmijët dhe opinionin e gjërë që të raportojnë rastet e krimit në SOS linjën e cila është ngritur pranë Ministrisë së Drejtësisë.**

6. Sistemi dhe shoqëria civile

Nën-këshilli i Zhvillimit të Sistemit dhe Shoqëria Civile kishte për qëllim identifikimin dhe vlerësimin si dhe evidentimin e kapaciteteve të komunitetit për t'iu përgjigjur nevojave të mbrojtjes së fëmijëve si dhe rolin e organizatave të shoqërisë civile për t'iu përgjigjur çështjeve të mbrojtjes së fëmijëve.

Për arritjen e këtij qëllimi, ky nën-këshill ishte përgjegjës për plotësimin me informacion të instrumenteve të mëposhtme:

Instrument 2d:	Strukturat e komunitetit, funksionet dhe kapacitetet
Instrument 2e:	Shoqëria Civile dhe Përgjegjësia Publike

Mbledhja e informacionit është realizuar përmes organizimit të dy punëtorive me pjesmarrjen e anëtarëve të nën-këshillave, duke synuar:

- Përshkrimin e aktorëve kryesorë të komunitetit në mbrojtjen e fëmijëve në nivel komuniteti;
- Përshkrimin e mekanizmave referues, të cilët funksionojnë në nivel komuniteti;
- Përgatitja e organogramit të një sistemi “tipik” të mbrojtjes së fëmijëve në nivel komuniteti;
- Përshkrimin e koordinimit të përgjithshëm ndërmjet komunitetit të shoqërisë civile në fushën e mbrojtjes së fëmijëve; dhe
- Vlerësimin e pikave të forta dhe pikave të dobëta në sistemin e mbrojtjeës së fëmijëve në nivel komuniteti.

6.1. Gjetjet kryesore

1. **Roli i njësive të qeverisjes vendore (komunave) në mbrojtjen e fëmijëve:** Komunat kanë autoritet të plotë në lidhje me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe për ofrimin e shërbimeve familjare dhe të mirëqenies sociale, përfshirë edhe përkujdesjen ndaj fëmijëve. Megjithatë, pavarësisht këtij parashikimi ligjor, nuk ka një referencë të qartë për fëmijët çka do të lejonte trajtimin e tyre si një kategori e veçantë dhe duke i vendosur ata në fokus të aktivitetit të komunës. Gjithashtu, Ligji Nr.03/L-040 “Për Vetëqeverisjen Lokale” parashikon themelimin e këshillave komunale përgjegjëse për të siguruar një mbrojtje të përshtatshme të të drejtave të komunitetit, duke i kthyer ata në palë të rëndësishme në nivel lokal, por pa përcaktuar në mënyrë të veçantë detyrimin për mbrojtje të një grupi të caktuar, siç janë fëmijët në këtë rast.
2. **Qendra për Punë Sociale luan një rol kyç në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve në nivel lokal:** Qendra për Punë Sociale është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare duke përfshirë mbrojtjen e fëmijëve. Qendra për Punë Sociale kanë një varësi të dyfishtë: nga Departamenti i Mirëqenies Sociale, pranë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale si dhe nga DSHMS në nivel të Komunës. Qendra për Punë Sociale bashkëpunon me sektorin e OJQ-ve në përmbushjen e mandatit të saj. Megjithatë, Qendrat për Punë Sociale kanë mungesë të burimeve njerëzore dhe të infrastrukturës

në përgjithësi që do t'i lejonte të kishin një koordinim më të mirë me struktura të tjera në nivel lokal. Në këtë kuadër, duhet të zhvillohet një program studimor për punonjësit social dhe se ky program duhet të licencohet. Përndryshe, Qendra për Punë Sociale nuk kanë punonjës social të cilët merren me çështjet e mbrojtjes së fëmijëve në strukturat e saj.

3. **Mungesa e veprimeve të koordinuara të ofruara nga OJQ-të në nivel lokal** Njësia për të Drejtat e Njeriut në nivel komune rezulton të jetë struktura më e përshtatshme për koordinimin dhe mbikëqyrjen e strukturave të mbrojtjes së fëmijëve. Pavarësisht mbikëqyrjes hierarkike të strukturave në nivel lokal nga niveli qendror, mungojnë strukturat lokale, të cilat do të luajnë rol monitorues. Në praktikë evidentohet një dyfishim aktivitetesh për shkak të mungesës së koordinimit ndërmjet OJQ-ve, të cilat shpesh ofrojnë shërbime të njëjta, duke krijuar përshtypjen se ekziston një grup i favorizuar dhe nuk ofrohen shërbime për grupe të tjera. Në këtë kuadër është e nevojshme të sigurohet një ndërhyrje e koordinuar në ofrimin e shërbimeve në nivel lokal. Për më tepër, evidentohet mungesa e monitorimit dhe vlerësimit të OJQ-ve si ofrues, e cila shoqërohet me mungesën e transparencës në lidhje me fondet.
4. **Koordinimi ndërmjet sektorit publik dhe shoqërisë civile** Ka një koordinim ndërmjet strukturave shtetërore dhe OJQ-ve përmes ofrimit të granteve për realizimin e aktiviteteve të ndryshme të ofruara nga shoqëria civile. Megjithatë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtorive të Shërbimeve të Mirëqenies Sociale në nivel lokal kanë kritere të qarta për dhënien e tyre, të cilat parashihen në Ligjin për Prokurim. Shërbimet sociale nuk blihen apriori, por vetëm atëherë kur ka nevojë dhe kur ato shërbime nuk ofrohen prej shërbimeve publike. Ekzistojnë rregullat e blerjes së shërbimeve që janë të përcaktuara me ligj. Kjo edhe bëhet duke tenderuar ato shërbime për të cilat ka nevojë për blerje. OJQ janë mbështetje për shërbimet publike dhe në mënyrë të pavarur nga institucionet publike ofrojnë shërbime. Me blerjen e shërbimeve krijohet partneritet mes shërbimeve sociale publike dhe OJQ-ve. Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare parashikon se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale mund të nënkontraktojë dhe të sigurojë shërbime nga OJQ-të në një përqindje të caktuar, ndërkohë pjesa tjetër e fondëve të nevojshme duhet të mbulohet nga buxheti i vet OJQ-së. Për më tepër, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka të drejtë të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi me OJQ-të, të cilat kanë marrë donacione për të siguruar lloje të ndryshme shërbimesh. Duke pasur parasysh se nuk ka një procedurë për licencimin e OJQ-ve, shërbimet mund të ofrohen nga OJQ-të edhe jashtë kuadrit të marrëveshjes me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Megjithatë, bashkëpunimi i sektorit publik dhe shoqërisë civile promovon aktivitetet sociale dhe përdoret si bazë për një bashkëpunim më të gjerë dhe shkëmbim informacioni ndërmjet dy sektorëve dhe ndihmon në adresimin më të mirë të nevojave të familjes dhe komunitetit. Nga ana tjetër, evidentohet se mbështetja e sektorit publik për shoqërinë civile ka qenë sporadike dhe nuk ka siguruar mjete të mjaftueshme, kjo edhe për shkak të mungesës së një baze ligjore të konsoliduar në këtë drejtim. Së fundi, vlen të përmendim se ekziston praktika e nënkontraktimit të shërbimeve sociale nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, kryesisht në lidhje me shërbimet e strehimit rezidencial ose familjar.
5. **Mungesa e standardeve për licencimin e OJQ-ve** OJQ-të janë të inkurajuar të ofrojnë shërbime sociale dhe familjare me iniciativën e tyre ose mbi bazën e një kontrate. Kontraktimi i shërbimeve realizohet në nivel komune në të gjithë Kosovën. OJQ-të, të cilat ofrojnë shërbime sociale në nivel kombëtar duhet të lidhin marrëveshje me Departamentin për Mirëqenie Sociale pranë Ministrisë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Megjithatë, nuk ka një procedurë licencimi për OJQ-të, ekziston vetëm një procedurë regjistrimi për programet e OJQ-ve, e cila bëhet në Ministrinë e Administratës Publike. Regjistrimi ofrohet në nivel kombëtar dhe licencimi gjithashtu do të jetë në nivel kombëtar. Mungesa e standardeve ka ndikuar gjithashtu në pamundësinë e vlerësimit të cilësisë së shërbimeve dhe monitorimin e aktiviteteve të realizuara nga OJQ-të. Me qëllim të matjes së cilësisë së shërbimeve sociale e familjare nga ofruesit e shërbimeve është në proces hartimi i standardeve minimale. Deri tani janë hartuar 5 standarde dhe në të ardhmen pritet të hartohen standardet e tjera. Në këtë drejtim është themeluar Këshilli i Përgjithshëm i Shërbimeve Sociale dhe Familjare, që është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të standardeve dhe disiplinës profesionale e në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare dhe në këtë vazhdë shërben si një organ regjistruar dhe licencues për profesionistët që punojnë në këtë lëmi.

6. **Ekziston një koordinim i përgjithshëm me anëtarët e shoqërisë civile në fushën e mbrojtjes së fëmijëve** i cili është arritur përmes ngritjes së Koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve, e përbërë nga 14 organizata. Një iniciativë tjetër për bashkëpunim ekziston ndërmjet OJQ-ve në Kosovë, e cila bazohet në llojin e aktivitetit të OJQ-së si p.sh Koalicioni i Strehimoreve (8 qendra strehuese).
7. **Evidentohet përfshirja e OJQ-ve në procesin ligjvënës në lidhje me politikat, legjislacionin dhe programet për mbrojtjen e fëmijëve në nivel kombëtar** OJQ-të janë përfshirë gjerësisht në procesin ligjvënës dhe kanë qasje në qarqet politikëbërëse. Përfshirja e shoqërisë civile në procesin ligjvënës në Kosovë është një detyrim që buron nga ligji. Bazuar në Studimin “Shoqëria Civile dhe procesi legjislativ në Kosovë”, 2008, marrja e opinionit të OJQ-ve në këtë proces, bazohet në arsyet e mëposhtme: (1) përfaqësimi i atyre, të cilët janë më pak të përfaqësuar, pasi OJQ-të sjellin zërin e atyre, të cilët janë të privuar nga e drejta e votës; (2) promovimi i dialogut pa rreziqe, dhe (3) dhënia e ekspertizës dhe alternativave të ndryshme. Në këtë kuadër, një shembull i mirë i bashkëpunimit të qeverisë me OJQ-të është Këshilli Kombëtar i Personave me Aftësi të Kufizuara, roli i të cilit është koordinimi, monitorimi si dhe dhënia e opinionit mbi politikat në këtë fushë.
8. **OJQ-të lokale në Kosovë nuk janë të qëndrueshme në lidhje me burimet e veta** Një faktor kyç, i cili ndikon në aktivitetet e shoqërisë civile në Kosovë, është fakti se pjesa më e madhe e OJQ-ve lokale kanë vështirësi në financime dhe ndikohen nga agjenda e donatorëve; po ashtu ekziston një numër i vogël i donatorëve të interesuar për mbështetje të qëndrueshme/afatgjate në fushën e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve. Kjo mbështetje është e fokusuar më shumë në tematikë se sa në sistem. Megjithatë, ka OJQ të cilat zhvillojnë aktivitetin prej një kohe të gjatë dhe kanë një strategji të qartë dhe burime të përshtatshme për përmbushjen e aktiviteteve të tyre strategjike dhe veprimeve.

6.2 Rekomandime

6.2.1 Amandamenti dhe plotësimi i strategjive ekzistuese dhe legjislacionit, duke përfshirë hartimin e ligjeve të reja dhe akteve nën-ligjore përkatëse:

- Finalizimi dhe miratimi i standardeve dhe kriterëve për licencimin e OJQ-ve (gjetja nr. 5)
- Përcaktimi i kriterëve të qarta për të siguruar fonde të qeverisë nga organizatat lokale—Në këtë kuadër, propozohet që minimumi prej 30% (kosto për shërbime dhe kosto administrative) të shpenzimeve/fondeve të nevojshme për shërbime sociale, të ofruara nga OJQ-të në kuadër të projekteve të ndryshme, të financohet në formë granti nga qeveria. (gjetja nr.4)

6.2.2 Rekomandime në lidhje me zbatimin e ligjit:

- Ngritja dhe fuqizimi i mekanizmave ligjor dhe institucional, të cilat do ta realizojnë monitorimin e cilësisë së performancës dhe kualitetit të shërbimeve të ofruara nga organizatat e shoqërisë civile. (gjetja nr. 3 dhe 5)
- Krijimi dhe freskimi i rregullt i një regjistri të OJQ-ve aktive, i cili do të bëjë të mundur identifikimin e OJQ-ve sipas kategorizimit të tyre/fushës së veprimtarisë. (gjetja nr. 5)

6.2.3 Rekomandime në lidhje me koordinimin ndërmjet institucioneve dhe funksionimin e sistemit:

- Mbështetja institucionale e organizatave në zbatimin e iniciativave të projekteve të qëndrueshme me qëllim të zvogëlimit të varësisë së tyre nga fondet dhe donacionet e jashtme—Në këtë kuadër, duhet të mbështeten iniciativa të cilat bazohen në bashkëpunimin e OJQ-ve me pushtetin lokal, me qëllim të uljes së kostove operative, krijimin e praktikave të mira dhe ngritjen e kapaciteteve të vetëqeverisjes vendore. (gjetja nr. 8).

7. Burimet financiare dhe kostoja e sektorëve dhe Programeve

Nën-këshilli i Mobilizimit të burimeve/kostoja e sektorit dhe e programeve kishte si qëllim identifikimin, vlerësimin dhe evidentimin e çështjeve kyçe në lidhje me burimet financiare dhe koston sektoriale dhe programore.

Qëllimi kryesor i këtij nën-këshilli ishte plotësimi i instrumenteve të mëposhtme:

Seksioni 4:	Mobilizimi i burimeve dhe përgjegjshmëria fiskale
Instrument 5c:	Përcaktimi i koston së sektorit
Aneksi A1:	Kostoja e ngritjes së kapaciteteve

Puna e këtij nën-këshilli ishte e fokusuar në mbledhjen e informacionit të rëndësishëm dhe plotësimin e instrumenteve të mësipërme me qëllim:

- Evidentimin e çështjeve të ndërlidhura në çështjet e financimit dhe buxhetimit të mbrojtjes së fëmijëve;
- Identifikimi i Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme, të cilat kanë një përfshirje dhe përgjegjësi më të madhe në mbrojtjen e fëmijëve; dhe
- Rishikimi i financimit publik dhe buxhetimit të të gjitha programeve të mbrojtjes së fëmijëve, si dhe të kostove specifike për ngritjen e kapaciteteve përmes asistencës teknike, trajnimeve, pajisjeve dhe investimeve të tjera.

7.1 Gjetjet kryesore për procesin e financimeve publike

Bazuar në informacionin e mbledhur, gjetjet kryesore në lidhje me çështjet e burimeve financiare, koston sektoriale dhe programeve janë:

1. **Ekziston Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH), e cila jep një përmbledhje të burimeve të vlefshme të projektuara për financimin e politikave prioritare të Qeverisë. Kjo kornizë udhëzon diskutimet e buxhetit vjetor.**
2. **Në KASH është i përfshirë ofrimi i shërbimeve për fëmijë, por mungojnë në mënyrë specifike objektivat apo aktivitetet me theks të veçante për mbrojtjen e fëmijëve.** Ndërkohe Qeveria ka bërë një përpjekje duke përpiluar një propozim-dokument për politikën sociale (arsimi, shëndetësia, mbrojtja sociale), i cili do të plotësohet dhe miratohet nga Qeveria. Në aspektin e mbrojtjes së fëmijëve parashikohet: (i) subvencionim për fëmijët në kuadër të ndihmës sociale me kushtin e ndjekjes së shkollimit të fëmijës si dhe (ii) përfitimet e drejtpërdrejta në kornizën buxhetore afatmesme. Megjithatë, ky projekt-dokument nuk përfshin referenca mbi aspektet shumë-sektoriale të mbrojtjes së fëmijëve.
3. **Në Republikën e Kosovës është miratuar “Ligji nr. 03/L-049” për Financat e Pushtetit Lokal” dhe “Ligji nr. 03/L-040” për Vetëqeverisjen Lokale“ ligje këto që përcaktojnë kompetencat e përbashkëta dhe ato të ndara ndërmjet dy pushteteve.** Sipas këtyre

ligjeve, aspektet shpenzuese që menaxhohen dhe kontrollohen nga agjencitë shtetërore në nivel lokal janë shpenzimet kapitale për ndërtimin e ndërtesave të reja, blerja apo shitja e aseteve publike. Shpenzimet e tjera si të pagave për punonjësit, shpenzimet e mirëmbajtjes së ndërtesave/ambienteve, shpenzimet e shkollimit, shërbimet shëndetësore menaxhohen nga komunat, por ekzekutimi i funksioneve të deleguara me ligj monitorohen nga ministritë përkatëse. Në fushën e mirëqenies sociale të gjitha përfitimet me para në dorë mbulohen nga niveli qendror, ndërsa shpenzimet e tjera nga pushteti lokal. Sektorit i arsimit ka kryer decentralizimin për shpenzimet operative ndërsa një pjesë e shpenzimeve kapitale mbeten në nivel qendror. Ndonëse këto ligje përcaktojnë kompetencat ndërmjet dy pushteteve, ajo që konstatohet është se procesi i decentralizimit ende nuk ka përfunduar dhe ka ecuri të ndryshme sipas sektorëve. Konkretisht, decentralizimi ka shënuar progres për shërbimet sociale dhe po ashtu ka një dinamikë pozitive për sektorët e arsimit dhe shëndetësisë. Ndërsa për çështjet e drejtësisë duket vështirë që decentralizimi të ndodh në një kohë të afërt. Në këtë kuptim, përcaktimi i financimit të mbrojtjes sociale, përfshirë mbrojtjen e fëmijëve nuk është sa duhet i qartë.

4. **Është përcaktuar burimi i financimit për shërbimet sociale të cilat përfshijnë mbrojtjen e fëmijëve nëpërmjet grantit të përgjithshëm** dhe aktualisht po punohet për formulën e financimit. Ajo që konstatohet është se ndonëse disa nga komunat kanë disa rregullore sesi t'i shpenzojnë fondet, kapacitetet e tyre janë të dobëta dhe profesionistët nga institucionet e ndryshme nuk e kanë të qartë si ta trajtojnë mbrojtjen e fëmijëve. Për këtë qëllim është e nevojshme që paraprakisht të fuqizohet procesi i decentralizimit. Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë kanë grante specifike, por është evidente se ato nuk alokohen sa duhet në nivelin lokal për mbrojtjen e fëmijëve.
5. **Ndonëse ekzistojnë kapacitetet në nivel ministrie që kanë mandat për mbrojtjen e fëmijëve dhe për të bërë propozime buxhetore,** nuk mund të gjykohet nëse janë në gjendje të artikulojnë propozime të mira ose jo, veçanërisht për mbrojtjen e fëmijëve. Kjo pasi në sistem janë evidentuar mungesa në aspektin e njohjes së konceptit të mbrojtjes së fëmijëve, të të dhënave dhe të stafit të pa specializuar për të propozuar buxhetin për mbrojtjen e fëmijëve.
6. **Ekzistojnë kapacitetet për zhvillim, ekzekutim dhe monitorim të politikave për mbrojtjen e fëmijëve, por nuk janë të harmonizuara ose nuk janë mjaft funksionale.**
7. **Përcaktimi i kostos së strategjive të mbrojtjes së fëmijëve është pika më e dobët e evidentuar gjatë procesit të vlerësimit. Nuk ka Strategji për mbrojtjen e fëmijëve, por shumë nga aspektet e mbrojtjes së fëmijëve të cilat, trajtohen në kuadër të “Strategjisë për të Drejtat e Fëmijëve 2009-2013” dhe strategjive të tjera në fusha të ndryshme.** Fushat e përfshira në këto strategji janë: arsimit, shëndetësia, qeverisja, buxheti, mirëqenia sociale, drejtësia për të mitur dhe çështje të tjera ndërsektoriale, porse Qeveria nuk ka opsione apo skenarë të ndryshme të financimit. Buxheti bëhet mbi bazën e eksperiencës së mëparshme pa marrë parasysh prioritete të reja apo pa bërë vlerësim të kostove dhe performancës së mëparshme. Ndihma e donatorëve nuk është e koordinuar në lidhje me financimin e strategjive dhe kjo përben problem edhe në kuadrin e njohjes nga ana e strukturave përgjegjëse për të qene në dijeni për financimet e ofruara nga secili donator.

8. **Nuk ekziston një strukturë e posaçme brenda Qeverisë për të avokuar për prioritetet e mbrojtjes së fëmijëve dhe buxhetimin e tyre** Brenda Qeverisë evidentohet se ekzistojnë këto struktura: (i) Këshilli Ndërministror për të Drejtat e Fëmijëve (ii) Zyra për Qeverisje të Mirë pranë Kryeministrit si dhe (iii) Njësitë për të Drejtat e Njeriut në ministritë e linjës dhe në nivel komunal. Ndikimi i këtyre strukturave në lidhje me avokimin për prioritetet dhe eventualisht për buxhetimin e tyre, është vlerësuar të jetë jo i mjaftueshëm dhe takimet e komitetit ndër-ministrior mbledhen rrallë (dy herë në vit) dhe nuk kanë për objekt marrjen e masave buxhetore për prioritetet.
9. **Ka dialog të kufizuar me donatorët mbi prioritetet e mbrojtjes së fëmijëve.** UNICEF ka bashkëpunuar me Zyrën e Qeverisjes së Mirë në lidhje me prioritetet për mbrojtjen e fëmijëve, por nuk janë zhvilluar diskutime me donatorë të tjerë. Prioritet mund të jetë parandalimi i dhunës në familje në mënyrë që të parandalohet trafikimi i fëmijëve. Organizata e Kombeve të Bashkuara ka kuptuar që duhet të ketë një bashkëpunim dhe se UNICEF është i qartë në lidhje me prioritetet e veta dhe me avokimin që po bën. Po kështu, USAID ka mbështetur viktimat e trafikimit dhe dhunës; UNDP ka dhënë mbështetje në aspektin e politikave kundër dhunës në familje dhe trafikimit; Ministria e Punës dhe Mireqenies Sociale është e përfshirë në skemën e ndihmës sociale ndërsa DFID po punon për formulën e shpërndarjes së fondeve nga nivel qendror në nivel lokal për shërbimet sociale përfshirë edhe mbrojtjen e fëmijëve. Për hartimin e Strategjisë kundër dhunës ICITAP, IOM, EULEX, u ftuan në një tryezë të përbashkët se bashku me organizata të tjera ndërkombëtare dhe të gjitha ministritë e linjës ku theks i veçantë i është dhënë mbrojtjes së fëmijëve ndaj trafikimit. Ka plane që në të ardhmen të zgjerohet bashkëpunimi që të përfshihen donatore të tjerë edhe në fusha të tjera të mbrojtjes së fëmijëve. Plani i përbashkët i zhvillimit 5 vjeçar i UN Kosovo Team do të zgjidh çështjet rreth nevojave të financimit të programeve të ndryshme duke përfshirë programet e mbrojtjes së fëmijëve.
10. **Shërbimet në kuadër të mbrojtjes së fëmijëve ofrohen si nga Qeveria ashtu dhe nga OJQ të ndryshme, shpesh duke u përkrahur nga donatorë të ndryshëm.** Shërbimet nga sektori publik janë kryesisht pa pagesë, megjithëse ekzistojnë edhe shërbimet me pagesë në fusha të caktuara. Shërbimet e ofruara nga sektori privat që janë pjesë e mbrojtjes së fëmijëve nuk janë plotësisht të rregulluara në aspektin ligjor si në aspektin e licencimit ashtu edhe në atë të përcaktimit të tarifave. Si lloje shërbimesh mund të përmenden në sektorin privat ngritja e kopshteve të fëmijëve, qendrave ditore, strehimoreve, etj, që jo domosdoshëm marrin fonde nga MPMS, ose agjencione tjera. etj. Megjithatë, në këtë kuadër pritet që rregullimi i ofrimit të shërbimeve nga të gjithë ofruesit do të qartësohet më tej sapo të zhvillohen dhe vihen në funksion procedurat e licencimit dhe standardet e shërbimeve, të cilat janë në zhvillim e sipër.

7.2 Gjetjet kryesore për financimin nga donatorët

1. **Nuk ka koordinim të mjaftueshëm për mbrojtjen e fëmijëve mes qeverisë dhe donatorëve, dhe se financimi nga ana e donatorëve nuk është rezultat i një procesi të konsultimit më të gjerë.** Edhe kur ndodh ky konsultim ai është i përkohshëm. Në praktikë ndodh që Qeveria nuk u paraqet donatorëve plane të financimit për të kërkuar fonde. Dhe kështu donatorët financojnë pa pasur një dakordim me Qeverinë. Megjithatë ekziston një koordinim mes vete i disa prej donatorëve si p.sh. UNICEF, ECLO, UNDP, IOM, të cilët konsultohen dhe diskutojnë për përmbushjen e planit të veprimit për mbro-

jtjen e fëmijëve dhe planifikojnë së bashku si do të financojnë, por ky konsultim është i kufizuar. Megjithatë ky rol tani i ka kaluar Ministrisë së Integritimit Evropian (MIE). Për sa i përket sektorit të mirëqenies sociale donatorët diskutuan në një tryezë të përbashkët në prill 2011. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka rënë dakord me ECLO për një marrëveshje konsultative se çfarë do të financohet prej tyre dhe çfarë do të financohet nga ministria dhe me çfarë përqindje. Gjithashtu vihet re se edhe kur ministritë kërkojnë ndihmë dhe financim sipas prioriteteve të ministrisë ato ndeshen me barrierat e programeve të donatorëve. Kështu p.sh. Ministria e Drejtësisë ka kërkuar ndihmë për ndërtim kapacitetesh nëpërmjet IPA-s, si dhe financim nga USAID, por nuk është pranuar sepse donatorët kanë pasur programet e tyre të caktuara të donacioneve. Në këtë rast ajo që ndodh është se ministritë u drejtohen ambasadave për të cilat shpeshherë nuk njoftohet MIE. Arsyeja pse ka koordinim të kufizuar është sepse mbrojtja e fëmijëve është shumë-sektoriale.

2. Ekzistojnë grupet dhe nën-grupet sektoriale për përforcimin e koordinimit të

donacioneve mes donatorëve dhe qeverisë, si: 1. Kundër korrupsioni dhe krimi i organizuar; 2. Viza, azili, menaxhimi i kufirit, dogana dhe policia; dhe 3. Gjyqësori. Por në fushën e mbrojtjes së fëmijëve nuk ekzistojnë mekanizmat e përmendur. Ekziston një nën-grup për mbrojtjen e fëmijëve, por nuk funksionon. Në vitin 2010 është zhvilluar vetëm 1(një) takim. Moskoordinimi vjen sepse nuk ka staf të mjaftueshëm nëpër ministritë përkatëse dhe ka një vendim të Qeverisë për ngritjen e njësisë të koordinimit të donacioneve BE nëpër çdo ministri.

3. Donatorët shfaqin interes për t'i financuar programet e mbrojtjes së fëmijëve, megjithatë, fokusi është më tepër mbi çështje me bazë programi që përfshijnë të gjitha moshat dhe kategoritë e tilla si antitrafikimi dhe dhuna në familje.

7.3 Gjetjet në alokimin e buxhetit në nivelin sektorial dhe të programit⁷

1. Analiza e të dhënave e sektorit të mbrojtjes së fëmijëve

Sektori i mbrojtjes së fëmijëve⁸ paraqet 1.5% të buxhetit të përgjithshëm të Republikës së Kosovës për periudhën 2010–2015. Në përgjithësi, trendi i buxhetit për këtë sektor ka qenë në rritje e sipër përveç për vitin 2013 dhe 2014 ku është vërejtur një rënie.

Programet më të rëndësishme të sektorit të mbrojtjes së fëmijëve janë ato të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale me një buxhet mesatar prej 67% të buxhetit të përgjithshëm për vitin 2010-2015 dhe 0.9% të buxhetit të përgjithshëm të Republikës së Kosovës për periudhën e njëjtë kohore.

7 Për më tepër informata lidhur me të dhënat e buxhetimit, ju lutem ju referoheni seksionit 5c dhe anekseve në kuadër të bashkësisë së instrumenteve (bashkësia e instrumenteve është po ashtu e përfshirë në CD).

8 Shih skemën e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, aneksi 1

Programet e buxhetuara të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale janë:

- Asistenca sociale
- Shërbimet sociale
- Kujdesi institucional
- Instituti i politikave sociale
- Inspektorati i punës
- Skema e invalidëve të luftës

Programet me pjesën më të madhe të buxhetit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale janë ato të asistencës sociale dhe të shërbimeve sociale, të cilat në total për këtë sektor arrijnë 27% dhe 21% respektivisht. Programet e arsimit arrijnë në 27% të buxhetit të përgjithshëm të mbrojtjes sociale.

Programet e buxhetuara të Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë janë:

- Arsimi për nevoja të veçanta
- Instituti Pedagogjik
- Administrata Qendrore
- Trajnimi i mësimdhënësve
- Zhvillimi i projekt-programeve

Programet më të rëndësishme të buxhetit të përgjithshëm për arsimin janë shpenzimet e administratës qendrore, e cila në total arrin 17% të sektorit.

Programet e Ministrisë së Shëndetësisë paraqesin 7.8% të buxhetit të përgjithshëm të mbrojtjes sociale, ku pjesa më e madhe përfaqësohet në programin për nëna dhe fëmijë me 2.3% të sektorit në përgjithësi.

Programet e buxhetuara të Ministrisë së Shëndetësisë janë si në vijim:

- Qendra Klinike dhe Universitare e Kosovës (QKUK)
- Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës (IKSHPK)
- Programi HIV/AIDS
- Trajtimet jashtë vendit
- Programi për nënën dhe fëmijën
- Shërbimet e shëndetit mendor

Në përfundim, duke e pasur parasysh faktin se Republika e Kosovës nuk ka përgatitur ende ndonjë strategji për “Mbrojtjen e Fëmijës” është e vështirë të gjykohet nëse buxheti i reflektton sa duhet prioritetet e kësaj fushe. Megjithatë, pesha që ka ky sektor në buxhetin e përgjithshëm të Kosovës tregon se Qeveria po bën përpjekje të alokojë fonde për mbrojtjen e fëmijës.

Ajo çka duket, është se programet për ndërtimin e kapaciteteve në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë kanë burime të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve ose nga fondet publike ose nga donatorët kryesorë të cilët financojnë për mbrojtjen e fëmijës si UNICEF-i dhe BE-ja.

2. Analiza buxhetore e sektorit të drejtësisë dhe të sigurisë

Sektori i drejtësisë dhe i sigurisë paraqet rreth 0.5% të buxhetit të përgjithshëm të Kosovës për periudhën 2010-2015.⁹ Edhe pse sipas të dhënave pasqyrohet që buxheti për këtë sektor është në rënie, përsëri ky nuk është një pasqyrim i realitetit pasi përveç Ministrisë së Drejtësisë, e cila i ka regjistruar të gjitha të dhënat e nevojshme, institucionet e tjera të përfshira në këtë sektor nuk janë në gjendje të ofrojë parashikime për vitet e ardhshme. Kjo për shkak se krahas institucioneve të sektorit të mbrojtjes sociale i cili mund të ofrojë asistencë sociale për kategoritë e fëmijëve të cilët i nënshtrohen mbrojtjes sociale si abuzimit, braktisjes apo neglizhimit, etj. etj, institucionet që veprojnë në fushën e drejtësisë dhe të sigurisë nuk mund t'i parashohin rastet e përdhunimit në të ardhmen dhe në fund të fundit kjo nuk do të kishte ndonjë kuptim.

Programet me më shumë peshë për sektorin e sigurisë dhe të drejtësisë përfaqësohen me programet e Ministrisë së Drejtësisë, me një buxhet mesatar prej 81% të buxhetit të përgjithshëm të sektorit për vitet 2010-2015 dhe 0.5% të buxhetit të përgjithshëm të Republikës së Kosovës.

3. Shfrytëzimi i të dhënave nga qeveria dhe donatorët

Procesi i vlerësimit të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve dhe i alokimit të buxhetit për Qeverinë e Republikës së Kosovës konsiderohet si inovative sepse ky është vlerësimi i parë që është bërë ndonjëherë dhe për shkak të gjithëpërfshirjes së tij. Ky proces i shërben Qeverisë në shumë fusha për:

1. Identifikimin e institucioneve të përfshira në mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimi relevant ndërmjet sektorëve të ndryshëm.
2. Kuptimin se sa e rëndësishme është mbrojtja e fëmijës nga pikëpamja buxhetore. Në veçanti, nëse alokimi i buxhetit për mbrojtjen e fëmijës është në nivelin të ulët kjo ndodh për shkak se nuk ka qenë fushë prioritare dhe si rrjedhojë ka buxhet të pamjaftueshëm për këtë sektor, ose mund të ketë prioritet (p.sh. siç është e përkufizuar në strategjitë ose dokumentet e tjera), por mungesa e fondeve në buxhet ndodh për shkak të mungesës së koordinimit mes strukturave relevante, ose për shkak se buxheti është tejte i kufizuar dhe nuk ofron hapësirë për alokim të buxhetit?
3. Kuptimin e ndarjes buxhetore afatgjatë për një periudhë 5 vjeçare në nivelin qendror dhe lokal. Kështu, ky paraqet një kornizë të dobishme sepse ofron projeksione të qarta se cilat fusha kanë më shumë buxhet e cilat më pak, dhe se shërben si bazë për kontrollimin nëse ka harmoni mes prioriteteve të përcaktuara për këto fusha dhe buxhetit.
4. vlerësimin e fushëveprimit të buxhetit të tërësishëm me qëllim të rritjes së mundshme dhe identifikimin e programeve të cilat mbështeten financiarisht dhe kanë elemente të mbrojtjes së fëmijës. Po ashtu, ka për synim analizimin, në veçanti, të programeve të mbrojtjes sociale (me para në dorë ose shërbime pa para në dorë) me qëllim të shikimit të programeve ekzistuese dhe përshtatjes së tyre me mbrojtjen e fëmijës dhe nevojës për implikime buxhetore.

9 Shih aneksin 3, Sektori i drejtësisë dhe sigurisë relevant për fëmijët.

Përcaktimi i kostos u shërben edhe donatorëve që të shohin se ku është përqendruar financimi i tyre dhe u ndihmon në bashkërendimin e përpjekjeve në mënyrë që mos të ketë dublikim të financimeve dhe si rezultat u ndihmon që të planifikojnë financimet e ardhshme. Së fundi, kjo ndarje gjithëpërfshirëse buxhetore i shërben Qeverisë për t'i bashkërenduar përpjekjet në kuadër të strukturave të veta dhe me donatorët.

Qeveria mund t'i përdor tabelat e kostove gjatë procesit të zhvillimit të strategjive që kanë elemente të mbrojtjes së fëmijëve dhe kurdoherë që vendos të hartojë një strategji të re për mbrojtjen e fëmijëve.¹⁰

7.4 Rekomandime

7.4.1 Amandamenti dhe plotësimi i strategjive ekzistuese dhe legjislacionit, duke përfshirë hartimin e ligjeve të reja dhe akteve nën-ligjore përkatëse:

- **Në rast të ndryshimit të ligjit për financat lokale të insistohet që të bëhen ndryshimet e nevojshme për fondet e burimeve të financimit për mbrojtjen e fëmijëve në të gjithë sektorët.** Bartës i realizimit të këtij rekomandimi duhet të jenë subjektet përgjegjëse të koordinimit lidhur me mbrojtjen e fëmijëve. Kur të përcaktohet mekanizmi që do të ketë përgjegjësinë për koordinimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, atëherë të reflektohet ky rekomandim. (gjetja nr. 3).

7.4.2 Rekomandime në lidhje me koordinimin ndërmjet strukturave dhe funksionimin e sistemit

- Në kuadër të grantit specifik, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për ofrimin e shërbimeve duhet të kenë politika të reja për mbrojtjen e fëmijëve dhe buxhet shtesë nga niveli qendror tek komunat.
- Ministria e Integritimit Evropian në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyrën e Kryeministrit, duhet të krijojë një grup apo nën-grup pune si strukturë e veçantë për koordinimin e mbrojtjes dhe drejtësisë për fëmijë.


7.4.3 Çështje në lidhje me ngritjen e kapaciteteve (trajnime), aktivitete të analizimit të situatës dhe vetëdijesimit:

- Fuqizimi i kapacitetit të “Këshillit për Mbrojtje dhe Drejtësi për Fëmijë” për vendosjen e prioritetëve dhe buxhetimin përkatës mbi bazë evidencash për të siguruar përmirësimin e raportimit dhe përgjegjshmërisë institucionale.


¹⁰ Të dhënat dhe informatat që i referohen sistemit të burimeve financiare dhe buxhetimit të programeve dhe sektorit janë nxjerrur nga veglat e caktuara të bashkësisë së instrumenteve, të përdorura dhe të kompletuara gjatë punës me anëtarët dhe aktorët e këshillit ndërministerial relevant për fushën e burimeve financiare.

- Nevoja për trajnime profesionale për pozicione kyçe në ministritë përkatëse (zyrtarë kryesorë financiarë, administrativë dhe zyrtarë të tjerë që merren me buxhetimin –ZKFA, ZKF duke qene se këto pozicione janë kyçe në planifikim dhe ekzekutim.
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal-Departamenti për të Drejtat e Njeriut, në vazhdimësi bënë monitorimin e Njësive komunale për të Drejtat e Njeriut, këshillon dhe udhëzon komnatat për buxhetimin e duhur për realizimin e aktivitete të tyre që dalin nga Strategjia dhe Plani i Veprimit për të drejtat e fëmijëve, të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Tashmë disa Njësi Komunale për të Drejtat e Njeriut, veç kanë nënkodin buxhetor si psh: Vitia, Vushtrria, Drenasi, etj. Megjithatë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duhet të luajë një rol më aktiv për të fuqizuar ndërtimin e kapaciteteve të komunave/Njësi Komunale për të Drejtat e Njeriut, në drejtim të qasjes së sistemit të mbrojtjes së fëmijëve dhe buxhetimit të duhur në lidhje me këtë sistem.
- Zyrës për Qeverisjes së Mirë dhe njësive për të drejtat e njeriut në ministritë përkatëse dhe komuna duhet t'i alokohet buxhet i mjaftueshëm për të lejuar kryerjen e plotë të mandatit të saj përfshirë atë të mbrojtjes së fëmijëve.
- Të nxitet pagesa e shërbimeve mbi bazë kontrate dhe performanca në nivel komune për mbrojtjen e fëmijëve.

Aneksi 2 - Skema e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në nivel lokal



Aneksi 3 - Skema e sistemit të drejtësisë dhe sigurisë



Bibliografia:

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
2. Kodi i drejtësisë për të mitur nr. 2010/0-L-193 .
3. Ligji ” nr. 2008/03-L-002 “Për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit Penal të Kosovës”
4. Ligji nr. 2008/03-L-003 “Për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës” .
5. Ligji nr. 03/L-238 “Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të Fëmijës”
6. Ligji i punës nr. 2010/03-L-212.
7. Ligji nr. 03/L-022 “Për përkrahjen materiale të familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuar te përhershme» .
8. Ligji nr. 2003/19 «Për sigurinë ne pune, mbrojtje te shëndetit te te punësuarve dhe ambientit te punës».
9. Ligji nr 2010/03-L-191 “Për ekzekutimin e sanksioneve penale”
10. Ligji nr. 03/l-182 “Për mbrojtjen nga dhuna në familje”
11. Ligji nr. 02/L-17 “Për shërbime sociale dhe familjare”
12. Ligjit nr. 03/L-040 «Për vetëqeverisjen lokale”
13. Ligji nr. 03/L-019 “Për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara”.
14. Ligji nr. 2003/15 “Për skemën e ndihmës sociale”
15. Ligji nr. 03L/-134, “Për lirinë e asociimit të OJQ-ve”
16. Ligji nr. 2004/46 për «Librat amzë» .
17. Ligji nr. 2002/2 “Për arsimin fillor dhe të mesëm”
18. Ligji nr. 2004/ 3 “Kundër diskriminimit” .
19. Ligji nr. 2004/32 “Për familjen”
20. Ligji nr. 2004/37 “Për inspeksionin e Arsimit në Kosovë”
21. Ligji nr. 2010/03-L/223 “Për Këshillin Gjyqësor të Kosovës”
22. Ligji nr. 2010/03-L-241 “Për prokurimin publik në Republikën e Kosovës”
23. Ligji i ri mbi Gjykata;
24. Projekt-ligji për Mbrojtjen e dëshmitarëve.
25. Statistika të Ministrisë së Arsimit 2009/2010;
26. Plani Strategjik i Ministrisë së Arsimit , Kosovë 2011-2016;
27. Studim i ESK, Studim demografik me UNFPA, 2003;
28. Studimi i Varfërisë i Bankës Botërore, 2005;
29. Studimi i gjendjes nutritive të shtatzënave dhe fëmijëve të moshës shkollore në Kosovë, UNICEF;
30. Statistika të ESK, 2009;
31. IKSHKP, 2010 Hulumtimi i kualitetit të shërbimeve të vaksinimit-LOT;
32. Raporti statistikor, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë;
33. IKSHKP, Raport i situatës epidemiologjike HIV/AIDS, 2009;
34. Statistika të OJQ-ve, Handikos;
35. Gjendja Perinatale në Kosovë për vitet 2000-2008;
36. Regjistrimi i faktit të lindjes në Kosovë, UNICEF 2008, Studim mbi punën e fëmijëve në Kosovë, UNICEF 2004;

37. Studimi "Hulumtim mbi dhunën ndaj fëmijëve në shkollat e Kosovës," UNICEF 2005;
38. Studim "Mbi mbrojtjen dhe ndihmën që ju ofrohet fëmijëve viktimë të trafikimit," UNICEF Kosovë;
39. Rregullore nr. 2001/14 "Për Themelimin e ESK";
40. Studimi demografik i fundit, 2003;
41. Udhëzim administrativ nr. 6/2005 për «Rregullimin e procedurave të përkrahjes financiare familjeve dhe individëve në rastet e jashtëzakonshme»;
42. Studimi «Siguria fillon në shtëpi»
43. Rregullorja 2001/4 "Për ndihmën e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore"
44. Raporti i Ombuspersonit. 2010;
45. Konventa "Mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave";
46. Konventa mbi të "Drejtat e Fëmijëve";
47. Strategjia Nacionale dhe Plani i Veprimit kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2008-2011;
48. Rregullorja e UMNK-ut "Për krijimin e strukturës parlamentare për mbrojtjen e fëmijëve";
49. Udhëzimi administrativ nr. 17/2008 "Për parandalimin dhe eliminimin e punëve më të rrezikshme për fëmijët në Kosovë" ;
50. Udhëzimi administrativ nr. 1/2010 "Për strukturën organizative dhe funksionale të agjencisë për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar" ;
51. Raporti i Progresit të Bashkimit Evropian për Republikën e Kosovës;
52. Strategjia dhe Plani Nacional i Veprimit për të drejtat e fëmijëve në Republikën e Kosovës 2009-2013;
53. Raporti përfundimtar i vlerësimit të programit të shoqërisë civile në Kosovë, Shkurt 2008;
54. Shoqëria civile dhe procesi legjislativ në Kosovë;
55. Strategjia "Për integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë në Republikën e Kosovës," 2009- 2015;
56. Strategjia "Për format e këqija të punës së fëmijëve" 2013 -2016;
57. Ligji Nr. 03/L-40 "Për përdorimin apo tregtimin e pesticideve";
58. Studimi i Departamentit për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete-Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik- Qendrat për Punë Sociale në Procedurat Civile, mars 2010;
59. Studimi i OSBE Gjykimi i rasteve familjare në Kosovë: Çështjet lidhur me menaxhimin e lëndëve, shkurt 2011; dhe
60. Studimi i Departamentit për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete-Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik, Mbrojtja Ligjore jo efektive, shtator 2010.